

Procesverbal

*Nga Mbledhja VIII (e tetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
29.09.2025*

Rend Dite

1. Dhënia e betimit të anëtarit të zëvendësuar nga KQZ, z.Nexhmi Dauti;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Anulimi i Vendimit për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat P - 70604032-00348-0, 70604032-00348-2, 70604032-00348-3, 70604032-00346-0, 70604032-00347-0, Zona Kadastrale Plavë II, me kulturë bujqësore, ara të klasës së 3-të, me pronar Burim Piraj;
4. Miratimi i Deklaratës Mbështetëse mbi Deklaratën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës Ndaj Grave në Politikë dhe Jetën Publike në Kosovë;
5. Propozimvendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028; dhe
6. Eventuale.

Arijeta Skeraj: I nderuar kryetar, kolegë asambleistë, përfaqësues i OSBE-së, mediave dhe të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në seancë e tetë të rregullt të Kuvendit për vitin 2025! Besoj se materialin për këtë seancë e keni pranuar me kohë dhe keni pasur mundësi të njiheni me përmbajtjen e tyre. Në rendin e ditës kemi gjithsej pesë pika dhe pikën eventuale. Para se të kalojmë te shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës, a do dikush me e marrë fjalën lidhur me rendin e ditës? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim! Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, 2 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë, e lus z.Nexhmi Dauti që ta japë betimin si anëtar i Kuvendit!

Nexhmi Dauti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë jam Nexhmi Dauti dhe, sipas pikës së rendit të ditës, po e jap betimin si anëtar i ri i Asamblesë. Bazuar në Nenin 35, Pika 4 e Ligjit 03/L040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008, si anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit jap dhe nënshkruaj këtë betim:

Unë, Nexhmi Dauti, betohem solemnisht se do t'i kryejë me nder, besnikëri, pa anime, me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Dragashit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, e vazhdojmë te pika e dytë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Anulimi i Vendimit për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat P - 70604032-00348-0, 70604032-00348-2, 70604032-00348-3, 70604032-00346-0, 70604032-00347-0, Zona Kadastrale Plavë II, me kulturë bujqësore, ara të klasës së 3-të, me pronar Burim Piraj. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

Nedžmidin Sejdilar: Ju falënderoj. Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, kolegët, delegatët. Një përshëndetje të veçantë për ju nga mediat. Po ju shoh në një numër pak më të këndshëm. Zonjë Kryesuese dhe i nderuar Kryetar në largim, unë konkretisht dua të di. Zonjë Kryesuese, a do t'i urdhëroni asistentit tuaj që të mos e pengojë punën e kuvendit? Kjo është e papranueshme dhe e paedukatë. Le të konsultohen ata në ndonjë kohë tjetër, çfarë është kjo pamje kështu. Të nderuar qytetarë, për shkak të paedukatësisë së pushtetit, unë duhet të pres derisa të konsultohen asistenti dhe kryetari, e pastaj të vazhdoj me fjalimin. Dhe ju lutem, zonjë Kryesuese, të mos lejoni gjëra të tilla. Le të dalin jashtë siç dalim të gjithë kur konsultohemi. Të mos e pengojnë punën e kuvendit dhe të mos e vënë në pikëpyetje dinjitetin e delegatëve dhe të tërë kuvendit. I nderuar kryetar në largim, a doni ju lutem, të jeni të sjellshëm ju ose ndonjë nga asistentët tuaj, drejtorët, bashkëpunëtorët tuaj, të vini tek kjo foltore e të na shpjegoni pse në mbledhjen e kaluar të gjithë u detyruam të votojmë për dhe ta ndryshojmë destinacionin e kësaj toke, e tani na e keni sjellë në rend dite që ta anulojmë. Mendoj se kjo nuk është e dobishme për komunën tonë, megjithatë bëhet fjalë për një biznesmen që punëson shumë qytetarë të komunës sonë, prandaj ju lus të na e shpjegoni bukur se për çfarë bëhet fjalë, në mënyrë që të di si të votoj atëherë. Faleminderit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 2 kundër dhe 5 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e katërt: Miratimi i Deklaratës Mbështetëse mbi Deklaratën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës Ndjaj Grave në Politikë dhe Jetën Publike në Kosovë.

DEKLARATË MBËSHTETËSE MBI DEKLARATËN PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS NDAJ GRAVE NË POLITIKË DHE JETËN PUBLIKE NË KOSOVË

Ne, përfaqësuesit e qytetarëve në Kuvendin e Komunës dhe në organet ekzekutive, të bashkuar në frymën e solidaritetit dhe qëllimit të përbashkët, shprehim mbështetjen tonë të plotë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë, të miratuar nga deputetet dhe deputetët nga partitë e ndryshme politike të përfaqësuara në mandatin e tetë legjislativ të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, ftoj nëpunësit civilë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të përqafojnë frymën e kësaj deklaratë në aktivitetet e tyre politike dhe qytetare, duke kuptuar se dhuna ndaj grave në politikë dhe jetën publike mbetet një pengesë serioze dhe e vazhdueshme për qeverisje gjithëpërfshirëse dhe demokratike, dhe se ajo dëmton pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në jetën politike. U bëj thirrje të gjitha institucioneve përkatëse nga të gjithë nivelet e qeverisjes që të ndërmarrin një qasje me ndikim dhe gjithëpërfshirëse, për të zbatuar në mënyrë kuptimplotë dispozitat e kësaj deklaratë. Duke nënshkruar miratimin e kësaj Deklarate mbështetëse, ne i bashkohemi thirrjeve të Deklaratës së 19 Nëntorit 2024 në komunat tona përkatëse, duke iu bashkuar kështu një fronti të unifikuar që përfshijnë aktorë të ndryshëm shoqërorë, për t'i dhënë fund luftës kundër dhunës ndaj grave në jetën politike dhe publike.

Atëherë, siç e dini, disa asambleiste nga Kuvendi i Dragashit kemi nënshkruar para disa muajve dhe ne këtë, dhe sot e qesim për me e mbështet. Atëherë, a do dikush rreth kësaj pike me e marrë fjalën? Në qoftrë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e pestë: Propozimvendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. E hapi diskutimin!

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderuar delegatë, përshëndetje për ju media, përfaqësues të OSBE-së, si dhe të gjithë ju të pranishëm! Jemi këtu për të folur për një pikë goxha të rëndësishme të rendit të ditës. Kështu që, e kam këtu së pari një kërkesë e cila ka ardhë prej banorëve të fshatit Shajne. Është fjala për ujësjellësine fshatit Shajne, i nderum kryetar. Unë e kqyra aty në planifikim buxhetor, por pse nuk ekziston një kod i veçantë për rregullimin e atij ujësjellësi, por në vend të kësaj ti ke shku edhe ju ke premtu që ke me e bo përmes fondit të MAPL-së, apo të Ministrisë për Zhvillim Rajonal, kur e din që ky fond është një fond që duhet përfshi të gjithë Komunën. Këtë pyetje e kam sa për fillim, mandej flasim. Faleminderit! Edhe ky premtim që ua ke bo qytetarëve të fshatit Shajne, të futet në listë me një kod të veçantë buxhetor, nëse është e mundur.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Unë e pashë listën e investimeve kapitale për 2026-2028, me të thënë të drejtën po më doket një copy-paste i 2024-tës. Shumë pak ka ndryshime,

kanalizim, ujë e shumë çështje. Ma shumë që më ra në sy, zvogëlimi në disa fshatra që u bo i buxhetit. Sidomos, kryetar, me sa kam mund me i mbledhë, në KAB, veç në Bresanë i ke pas 265 mijë euro. Tash, në listën e Propozim-buxhetit i ke diku rreth 125 mijë euro. Çka ka ndodhë me këtë shkurtim të buxhetit në Bresanë? Nuk mundesh me e bo me 75 mijë euro diku afër 4-5 km asfalt, qysh e ke parapa te “Ndërtimi i rrugës Rafshatina-Mali i Madh në fshatin Bresanë”. Me 75 mijë euro asfalt 5 km, nuk po e di qysh munden me ndodhë qekjo. Një çudi që po më vjen – ndërtimi i ndriçimit publik, i ke përfshi fshatrat Buqe, Zym, Zgatar, Pllajnik, Qollopek, Buzez, Brezne, disa fshatra i ke përfshi me 24 mijë e 500 euro. Te pika 11. A në fakt, ndriçim publik në qendër të fshatit Kuklibeg, 20 mijë euro. Ndriçim publik e ke pas në Kuklibeg e ke pas edhe vitin e kaluar. Nuk e di çka është ka ndodh me këtë ndriçim publik. 20 mijë vjet, 20 mijë sivjet, 40 mijë euro. Ose, ndriçim publik në fshatin Pllavë, vetëm ndriçim publik 45 mijë euro. Asnjë investim tjetër nuk ka. Është për çudi! Pse ka ndodhë qeky shkurtimi në Bresanë, edhe pse në disa vende e ke ndriçim publik vitin e kaluar që ke qit, prapë edhe sivjet. Ku ke me i çue – që veç po ta marr shembull – te Kuklibegi, ku ke me i çue qeto paret që e ke pas ndriçimin publik? Ose te fshati Pllavë, që e ke bo vjet, mos gabofsha 25 mijë ose 30 mijë, sivjet plus edhe 45 mijë euro ndriçim publik. Sa për fillim qeto!

Afrore Vejseli: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit! Këtu, duke e parë listën e shpenzimeve kapitale për vitin 2026-2028, e shoh vendin tim Zgatarin, që është i përfshirë me shumë pak projekte, duke e ditur që Zgatarin ka shumë problematika të tij. Në Zgatar, përveç që kubëzimet që janë përfshirë 35 mijë euro, unë propozoj që të shtohet edhe renovimi i rrjetit të ujësjellësit dhe sistemimin e ujërave të zeza. Tjetër projekt është edhe zhvillimi i pjesës turistike në Gjerman, duke përfshirë aty edhe renovimin e shumë shtëpizave që janë bërë. Është lënë në harresë, mund të theksojmë që në Zgatar asnjëherë nuk është folur për trashëgiminë kulturore. Aty e kemi mullirin që duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme. Kështu që, ia kisha propozuar qeverisë që ta ketë parasysh. Po ashtu, në këtë listën e shpenzimeve do ta kisha shti edhe rikonstruktimin e Stacionit të Autobusëve me infrastrukturë moderne, këtu në qytezë. Edhe po ashtu, një tjetër projekt, mirëmbajtjen e parqeve. Kryetar, ke bërë parqe, por ato nuk janë të mirëmbajtura. Po flas edhe si nënë, që sa herë shkoj në ato parqe, tmerrohem. Kam frikë që fëmija im të luaj, të ketë angazhimet ose aktivitetet e tij. Faleminderit!

Sefidin Mejzini: I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm! Përsëndetje për të gjithë! Të drejtën me thënë, jemi në kohë fushate edhe s’kam pas dëshirë me e marrë fjalën hiç me diskutu. Ne të

gjithë jemi për me mbrojt interesin e komuniteteve të ndryshme. Sa për fillim, kryetar, të uroj që ta kesh edhe një mandat, të kryjsh edhe punë tjera. Kam disa vërejtje, sa i përket investieve dhe mjeteve që janë ndarë, sidomos në fshatin tim. Janë disa mjete të ndara, nga leximi i parë te leximi i dytë e kemi një ndryshim, nga 82 mijë në 50 mijë. Duke e ditë që me infrastrukturë në fshat qëndrojmë shumë dobët në krahasim me shumë fshatra tjerë. Domethënë, mungon një fushë e futbollit që shumë fshatra e gëzojnë. Ndriçim publik nuk kemi në fshat, rruga e bjeshkës që ka qenë e hapur, nga vërshimet ka dalë jashtë sistemit edhe kërkush nuk e ka marrë mundin me një investim të vogël me e bo të qarkullueshme. Tash është sezoni i dimrit, me i pas sigurue do lëndë djegëse për dru, po kërkush nuk e ka marrë mundin. Edhe një kënd i lojërave i mungon fshatit. Thashë që nuk kam pas qef hiç me dalë, se është kohë fushate. Kolegia Afrore tha për në Zgatar, unë e di që ky projekti ujit ka qenë shumë pozitiv edhe i mirëseardhur, por disa fshatra i ka penalizue me projekte. Në Zgatar duhet me qenë të kënaqur që po shkon uji. Vjen uji, hiç mos u bëni marak. Shumica keni qef mos me u bo, unë po ju them që kryhet ajo. E kam edhe një kërkesë, kryetar, prej banorëve të fshatit Kapre. Janë 17 mijë me u shtue mjetet, edhe për një person e kanë një kërkesë – aty ku janë, është numër rendor 27, aty te projektet – ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në qendrën e fshatit Kapre, me e bo ndërtimi i murit mbrojtës nga vërshimet. Është në hyrje të fshatit. Ai është i rrezikuar. Është Asllan Kryeziu, më ka taku, ai ka qenë edhe ma herët, e ka lyp, ju i keni thënë po, por keni harrue me e shti tash te këto. Është si propozim me e shti edhe këtë, si aneks aty. Kam edhe një vërejtje sa i përket projektit, po nuk po e di a me e lënë në pikën eventuale, apo ta vazhdoj tash – projekti aktual që është në Kosavë, trevjeçar, i trotuarit. Punimet nuk janë të kënaqshme. E kam një vërejtje ma ta bo, se kërkush nuk e ka marrë mundin. Trotuari, vetëm për 10 metër gypa të betonit, në 5 vende ndërpritet. Kur është bërë projekti, projektuesi ka harrue me i shti në paramasa. Tjerat janë, me kubëza, me zhavorr, me krejt, vetëm që është harruar 10 metër gypa të betonit, edhe ai trotuari tash ndërpritet tash në 5 vende. Mirë është me e bo një angazhim. Edhe në fund dua ta shfrytëzoj, pasi jeni në garë të gjithë kolegët, ju uroj të gjithëve që të keni sukses. Edhe, kam qef që këta të LDK-së për nja 2-3 deputetë me u shtue. Faleminderit!

Suada Bajrami: Përshëndetje për të gjithë! Gjatë leximit të dytë buxhetor, i kam bërë do kërkesa të banorëve të fshatit Shajne. Këtu me kode nuk kanë ndryshue, si herën e kalume janë të njëjta. E kemi pas një mbledhje të Kryesise së fshatit Shajne, ku si kërkesa kanë ardhë: kanalizimi i shkollës së fshatit Shajne – ujërat e zeza po rridhkan në një zonë private, aty afër 200-300 metër është vendi për me dalë ujërat e zeza të fshatit. Edhe, mbi fshatin Shajne, rruga për te bazenet e fshatit, ka mbet

pa u shtruar për një 300 metër. Me ua lehtësuar banorëve me pas qasje më të lehtë në bazenet e fshatit, atje te ujërat. Kërkesa na qarkoren e dytë ka qenë rruga e bjeshtës edhe uji. Uji i fshatit është sjellë, po kanë të hapur gypat. Nëse ka mundësi, këto kërkesa me i pas parasysh. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Po flasim për një pikë shumë të rëndësishme të rendit të ditës, për buxhetin e vitit 2026. Kur e lexojmë buxhetin dhe shohim listën e shpenzimeve kapitale të parapara – po ndërlidhem direkt te fshati im në Zgatar, ku kjo qeverisje lokale e la diskriminuar për katër vite radhazi fshatin Zgatar me investime. Janë ndarë vetëm 25 mijë euro në fshatin Zgatar, për kubëzim, dhe një shumë e ndarë 30 mijë euro për shpronësimin e tokës, e cila për të katërtin vit radhazi nga buxheti i fshatit Zgatar. Çdo vit kemi ndarë parë për shpronësim nga buxheti i fshatit, 30 mijë euro, 20 mijë euro. Janë penalizim total i fshatit, për fshatin që është investuar ndoshta më së paku në qeverisjen tuaj. Kam bërë disa kërkesa si asambleist. Vitin e kaluar ke pas kërkesë për investim te pompat e ujit. 8 mijë euro i kemi ndarë nga buxheti i vitit të kaluar. Çka ke bo? E ke lënë tenderin deri në fundvit. Në fundvit e ke shpallë tenderin, ka ofertuar firma me çmim më të lartë, është anuluar tenderi, nuk ke pas kohë me e rishpallë tenderin. Ato parë të fshatit janë rikthyer në suficit. Të kanë bërë kërkesë për renovimin e pushimoreve në Gjerman. As që ke marrë mundin me dalë me i pa ndonjëherë në çfarë gjendje kanë qenë ato pushimore, vend i cili vizitohet nga shumica e banorëve tanë. Një pjesë e madhe e njerëzve edhe prej Prizrenit vijnë e bëjnë pushime aty, në vikend. Janë në gjendje të tmerrshme. Kam bërë kërkesë për pastrimin e deponisë ilegale, krejt çka ke arrit me bo si kryetar, ke dalë e ke vendosur një tabelë informuese “Mos hidhni mbeturina”. Kemi bërë kërkesë vitin e kaluar, me buxhetin e vitit të kaluar, që të bëhet edhe muri mbrojtës në pjesën e Serdanit. Nuk kemi parë tender, nuk kemi parë punime. Është fundi i vitit, hala asnjë punim nuk është filluar aty. Është bërë muri mbrojtës te Kuji i Mullinit. Po muri mbrojtës Te Serdani, është shumë nevojë urgjente, se rruga aty është gati me rrëshit. Nuk kemi parë tender edhe ajo pjesë ka me e prit fundin e vitit me u shpallë tenderi, edhe me u kthye prapë prapë në suficit. Po e shoh një ndarje buxhetore, që e ke përfshirë ndriçimin publik në fshatin Zgatar. Fshati Zgatar, sa për dijeninë tuaj, ndriçimin publik e ka bërë me mjete vetanake. Krejt çka i ka bërë kërkesë fshati Zgatar Komunës, që pagesën e faturës së rrymës ta bëjë Komuna, gjë të cilën e kemi refuzuar, me arsyetimin se nuk janë të kyçura në një orë. Investimi është komplet vetanak i fshatit, nuk ke qenë në gjendje me e bo një kabëll me e lidhë në një orë,

për me e bo pagesën e rrymës, qysh u janë bërë shumicës së fshatrave ku e ke bërë ndriçimin publik. Sa për fillim, për këto propozime kërkoj përgjigje, dhe vazhdojmë pastaj me debatin.

Agron Gashi: Ju përshëndes, të pranishëm! Meqenëse vij nga fshati Brezne, shqetësimet e qytetarëve drejtuar juve, kryetar, rruga që shpie në drejtim të Breznes në fshatin Buqe, është një rrugë e cila shfrytëzohet goxha shumë, automjetet qarkullojnë. Rruga ndodhet tek Mahalla e Bajraktarëve, e cila është e këndit 90 shkallë dhe kemi rrëshqitje të dheut. Është një kanosje e rrezikut për kalimtarët dhe, ashtu me automjete paksa më të mëdha, në mungesë të rrëshqitjes nuk mund të kalojnë. Është kërkesë e qytetarëve që lidh dy fshatrat, edhe Buqen, edhe Breznen, është që të intervenohet në atë rrugë. Unë konsideroj se është nuë vlerë më pak se 20 mijë euro – mendimi im personal – ndoshta inxhinierët e juaj do të kenë, nëse ekziston mundësia që të investohet, të bëjnë analizën e asaj rruge dhe është mirë që të intervenohet, me qëllim që t’u mundësohet qytetarëve të këtyre komuniteteve një kalim më të lehtë, që edhe të shkarkohen rrugët kryesore. Faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Pasi po diskutojmë për shpenzimet kapitale 2026-2028. Ia bëj një pyetje kryetarit, para se të fillojë të diskutohet për mbi 13 milionë euro investime, kur diskutohet për paga, për investime, për subvencione. Drejtorat e tu s’po t’i shoh këtu, kryetar, a qaq e neglizhojnë këtë popull – Beani, Behari, e shumë tjerë. Sot ish dashtë me qenë prezent ata, se për secilën drejtori diskutohet, edhe sidomos për investimet kapitale që i takojnë Bean Hadziasanit. Mos me qenë prezent, me na injorue neve, juve edhe gjithë popullatën, është e pafalshme, edhe kjo ndodh. Në ndarjen buxhetore para tre muajve, kryetar, ta kam thënë edhe në KPF, dua me ta cek, numër 2, ndërtimi i deponive të ngurta në Orqush dhe Rrenc, 80 mijë euro. Në reagimin tim këtu në Kuvend, edhe reagimin e fuqishëm të fshatit Rrenc, ju e keni largue, tash në listën e shpenzimeve kapitale për fat të mirë nuk është. Ta kam bërë pyetjen, po përgjigje nuk kam marrë. Sot po të pyesin qytetarët. A e ke largue vetëm për këtë vit që është vit zgjedhor, e vitin tjetër do ta propozosh, apo e ke largue deponinë për gjithmonë mos me qenë në fshatin Rrenc. Pyetja e dytë është, kryetar, në ndarjen buxhetore para tre muajve, Dragash, numër 4 ka qenë ndërtimi i kulmeve të ndërtesave në qytezën e Dragashit, 60 mijë euro. Pas reagimit tim, që kam thënë janë pak, i ke nda 30 mijë euro + 20 mijë. 11 ndërtesave t’u ndërrohen kulmet në Dragash me 30 a 40, ose 50 mijë euro, kjo është një hajgare me qytetarët, kur dihet se – kam pyet unë, po i kie inxhinierët e Komunës – 70 euro është 1 metër katror me e ndreq. 11 banesa, secila banesë i ka nga 250 metër katrorë, 3000 metër katrorë me 30 mijë euro, kryetar, një ndërtesë nuk mundesh

me e bo. Ma mirë mos na nënçmo kështu, atëherë kjo është një si pilot-projekt për me provue me një ndërtesë, se me 30 mijë euro një ndërtesë nuk mundesh me e ndërtue. Kemi pastaj këtu – edhe Dritoni i tha disa fjalë, nuk po due me e përsërit – ndriçimi në disa fshatra, 5 a 6 fshatra i ke nda 20 mijë euro për ndriçim, ndërsa në Kuklibeg edhe Pllavë, në secilin fshat i ke nda ka 20 mijë edhe 45 mijë. Nuk po di ku po i marrish këto. Në fshatin Rrenc, para tre muajve i ke nda 68 mijë euro për ndërtimin e murit mbrojtës tek varrezat dhe kubëzimi në fshatin Rrenc. Edhe aty kemi kundërshtue fort unë me qytetarët, që me këto pare që i ke ndarë, tash i ke ndarë 60 mijë. Prapë që kam kërkue unë, 8 mijë i ke largue. Me këto 60 mijë euro që i ke ndarë. I kemi kërkue qe dy vite. Murin mbrojtës që doni me e ndërtue te varrezat, atë murin mbrojtës, mos i harxhoni paret e fshatit me atë murin. Ato i keni prish ju, me kompaninë fituese. Dy vite na ke premtue këtu që këtë vit do ta mbarojsh, nuk e ke mbarue, tash e ke qit në buxhetin e fshatit Rrenc. Po të kërkuj, në emër të fshatit, ato 60 mijë eurot mos i prek për fshatin. Është jo e mirë, kryetar, se të dënojnë qytetarët. Ti e dish shumë mirë, në shkurt me 17 vota ke mbet, tash po shkojsh e po mbesish me 7, e po më vjen keq. Tjetër, numër 56: Ndërtimi i terreneve sportive në Lubevishtë, e 18 mijë euro. Sa terrene kie me i ndreq, kryetar? Se t'është një terren, apert po të besoj, veç shumë terren paske me ndreq. Sa terrene janë ato – se qetu jetoj unë, Lubevishtin e kam 200 metër vijë ajrore. Shkojmë më poshtë, kryetar, te shërbimet e shëndetësisë primare, renovimi i QMF-së, AMF-së në fshatrat e Gorës, Restelicë, Brod, Rapçë, Vraniç, Radeshë, me 30 mijë euro. Me 30 mijë - euro në Krushevë me 300 mijë euro ke marue QMF – po më vjen mirë që ke marue – në fshatin Restelicë, me 10 mijë banorë – me dy dhoma, një e mjekut edhe një me një krevat, 10 mijë banorë, tan verën, kryetar, është e pafalshme. Kulturë, Rini dhe Sport, ndërtimi i stadionit në fshatin Blaç. Ju kujtohet shumë mirë, në 2022-tën në mënyrë urgjente, bile kolega Sef na pat bo apel me e votue 50 mijë euro, se s'ka ku me lujt KF “Opoja”. Prej 2022-tës deri më 2026-tën, pauzë e madhe është, kryetar. Çka ke investue atje me këto 50 mijë, ku keni mbet, edhe me qeto 70 mijë eurot a do të ndreqet apo duhet hala pare? Edhe krejt në fund e kemi Arsimi dhe Shkenca, renovimi i të gjitha shkollave në regjionin e Gorës – 42 mijë euro. Cilat shkolla ke me i ndreq, kryetar? A në gjuhën boshnjake që shkojnë, a që shkojnë me sistem paralel, apo edhe me ndonjë sistem bullgar, mos ka dalë deni Uzair Hamza, helbete?

Munir Jonuzi: Faleminderit znjë Kryesuese, i nderuar Kryetar, të nderuar kolegë delegatë, të nderuar media, të nderuar anëtarë të pushtetit ekzekutiv, të nderuar përfaqësues të OSBE-së dhe të gjithë mysafirët e pranishëm. Para nesh është miratimi i buxhetit për vitin 2026. Ajo që doja të

pyesja kryetarin dhe gjithë pushtetin ekzekutiv është: mbi cilat kritere është përpiluar ky buxhet? Cilat kanë qenë kriteret për përgatitjen e këtij buxheti? Së dyti, më intereson raporti: sa është përqindja e investimeve kapitale në Gorë, sa në Opojë? Jo vetëm përqindja, por edhe shuma e saktë. Sepse në krahasim me draft-buxhetin që na u dorëzua në muajin qershor të këtij viti, kemi ndryshime të mëdha, sidomos kur bëhet fjalë për komunitetin jo-shumicë. Pyetja tjetër është ndërtimi i rrugës, kodi 44, ndërtimi i rrugës Kukuljan–Dragash. 15 plus 10, 25 mijë. Sipas draftit që kishim në qershor, për atë rrugë ishin paraparë 100 mijë euro. Më tej, kemi ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Brod, është shtuar për 5 mijë, më herët kishim 10, tani kemi 15, sipas nevojave ndoshta është në rregull. Pastaj vijmë te Radesha: në draftin e buxhetit kishim paraparë 70 mijë, tani 60 mijë, z. Kryetar. Pastaj kemi Krstec, kishim paraparë 45 apo 50, nuk e di saktë tani, por tani kemi 40 mijë dhe aty ka ardhur deri te një ulje. Pastaj kemi fshatin Vranište, kishim paraparë 44,5 mijë, tani 30 mijë. Fshati Rapçë, kishim paraparë 95 mijë, tani 90 mijë, për të njëjtat projekte. Të gjitha këto i bëjmë. Lluboshtë, fshati Lluboshtë, kishim paraparë 30, tani 18 mijë. Ku kemi edhe ulur tjetër? Jo, por ja, kemi rritur. Ku kemi rritur? Në fshatin Krushevë. Fshatit Krushevë ia kemi rritur tash nga 29 mijë në 69 mijë. Të gjitha këto që i kemi hequr, ia kemi dhënë fshatit Krushevë. Pra, z. Kryetar, meqë ky buxhet bazohet në regjistrimin e vitit 2024, a e dini sa banorë ka fshati Krushevë? Dhe a e meriton vërtet ky fshat një përqindje kaq të lartë të investimeve kapitale? Sepse më elementarja, më logjikja dhe ajo mbi të cilën duhet të bazohet buxheti i komunës sonë është përqindja e përfaqësimit të komunitetit shumicë dhe jo-shumicë. Kur ndajmë përqindjet në Gorë, atëherë është edhe përqindja e secilit fshat. Nëse Krusheva është në vendin e gjashtë për nga numri i banorëve, pse në buxhet të jetë në vendin e tretë? A mendoni ju se fshatrat Rapçë, Radeshë, Vranište, Krstec e me radhë, Restelicë, nuk kanë nevojat e tyre? Apo vetëm fshati Krushevë? Pra, përqindjen e saktë të buxhetit dhe shifrat e sakta: sa është në Gorë, sa është në Opojë. Shohim se këtu në fillim keni vendosur eksproprijimin e pronës së AKP-së në Dragash dhe Brodosavc. Dhe këtë e llogaritni 60 mijë. Këtë e llogaritni si të përbashkët, meqë bëhet fjalë për eksproprijim në Dragash dhe në fshatin Brodosavc. Me të vërtetë ka shumë pika të tilla, ku thjesht nuk më del përqindja e buxhetit që është respektuar sipas ndarjes “Fer-Share”. Më tej, kemi, z. Kryetar, tek kodi 41, sufinansimin e projekteve me donatorë të ministrisë për zhvillim rajonal dhe ministrisë për vetëqeverisje lokale. Aty janë ndarë 230.500 euro. 177.000 janë ndarë për rregullimin e linjës së tensionit të lartë drejt Restelicës. Më intereson, pjesa tjetër prej 50.000 për çfarë është e destinuar? Dhe z. Kryetar, në buxhetin tuaj thuhet se në këtë vit numri i të punësuarve

nuk duhet të kalojë 764 të punësuar. Mua më intereson: sa janë të punësuar në administratën komunale, respektivisht në administratën publike në ndërtesën e kësaj komune? Faleminderit.

Nexhat Selaj: Përshëndetje për të gjithë! E shoh këtu se secili nga asambleistët mbron edhe interesat e atij lokaliteti se nga vjen. Çka do të bëjmë për lokalitetet tjera të cilat nuk kanë asambleist. Bie fjala, unë do të nisem nga fshati Pllavë, tani do të vendosem tek fshati im nga vij. Me 60 mijë euro të ndara, ku mbet stadiumi, kryetar. Ishte i planifikuar që në periudhën e vitit 2023, ashtu sipas juve, të përfundojë i tëri. Jo në 2023, e 2024-ta, po mbaron edhe 2025-ta, banorët e fshatit seriozisht kanë shqetësime në atë vend. Nëse është bërë një gabim më i madh gjatë qeverisjes tuaj, unë do ta konstatoja se problemi më i madh është prishja e atij terreni. Për Pllavën. Nëse mund të them se mund të është gabimi më i madh, kishte me qenë shkatërrimi i asaj pasurie, asaj bukurie që e ka krijuar Allahu. E dëmtuat dhe e latë të tërin në atë gjendje si është. Pavarësisht se nuk është investuar, aty edhe në pjesët anësore, edhe me hektarë të shumtë u dëmtua nga materialet e ngurta të cilat u gjuajtën, qoftë në pjesën e majtë të rrugës, edhe në pjesën e djathtë. Seriozisht, qytetarët kanë ankesa të mëdha, dhe ato ankesa, me sa e di unë, dy apo tri ju kanë ardhë edhe tek ju, në zyrën tuaj. Do të bëhet, do të bëhet, deri tash nuk u bo. Shoh investimet në qytezën e Dragashit. Kryetar, duhet të jemi shumë transparentë edhe të flasim me letra çelë, se jemi të gjithë pjesë e këtij qyteti apo qyteze, si ta quajmë. Pasqyra e një shteti është kryeqyteti, po pasqyra e këtij lokalitetit tonë është Dragashi. E ke lënë këtë Dragash me të vërtetë për marre. Ashtu si edhe qeveritë e mëparshme – unë nuk do ta akuzoj vetëm qeverinë tënde tash katërvjeçare – me pak investime, është tmerr Dragashi. Duke filluar, në radhë të parë, me ndriçimin. 5 drita punojnë, 2 jo, 3 po. Është tmerr! Nuk ke këtu faj, se nuk je banor i Dragashit edhe nuk jetojsh këtu, nuk e dish. Tash, mund të thuash nuk është e vërtetë, por unë të isha lut, hajde një mbrëmje edhe e shiqojsh vetë. Nga këta qentë endacakë e ke mërzi edhe pa drita që banorët edhe fëmijët të dalin jashtë. Rrugët, kubëzimet, anësoret, i ke në mënyrën më të dobët të mundshme që është punuar deri më tani. Të flasësh për një kubëzim, edhe e shohim në infrastrukturë, të ndara diku rreth 20 mijë, 10 mijë, 30 mijë. Shoh, thuosh te lagjja e re, ujësjellësi. Dragashi ka nevojë për komplet sistemin e ndryshimit të rrjetit, kryetar. Jemi ndoshta vendi i cili e kemi ujin më të mirë në nivel vendi. Edhe ujin po thuesh do ta bie – mezi e pres që të vjen edhe duhet të jemi shumë krenarë i cili na vjen. Se për këtë ujin që po flitet shumë, një përparësi të madhe e ka ish-PDK e cila ishte në pushtet, e cila ka kontribuar në këtë çështje. Edhe partia juaj e cila po e sillni, nuk do të ju

akuzoj pse uji po vjen. Mbes me shpresë, ishalla vjen ma shpejt. Por, të vjen uji edhe të mos përdoret në qytezën e Dragashit, këtë e keni bërë vetëm në qeverisjen tuaj. Edhe nuk po shof që do të punohet edhe për këtë periudhë 2025-2028, që ke ndërmend të ndërrosh sistemin e ujësjellësit. Sistemi i ujësjellësit, pikërisht në qytezën e Dragashit, i përket viteve të 50-ta dhe 60-ta. Edhe në aspektin shkencor, edhe ju si mjek, shumë mirë e dini, ata gypa janë gypa të azbestit, janë gypa kancerogjenë, kryetar. Dhe të vjen uji, të harxhohen me qindra e mijëra euro, ndoshta edhe me miliona euro, nga bjeshkët e Sharrit deri në Dragash, dhe popullata të mos e shfrytëzojë, kjo ju takon vetëm juve që të jepni llogari, për këtë mandat katërvjeçar që keni premtuar se do ta ndërroni sistemin e ujit dhe nuk e keni bërë. Pikërisht bëhet fjalë për gypat. Ju jeni banor vetëm rezident gjatë ditës, kryetar. Nëse ju e përdorni për ujë të pijes, unë po kërkoj falje që po flas kështu, derisa ju nuk e përdorni për ujë të pijes, dhe ne të jetojmë në lartësitë 1000 metra, dhe të marrim ujin nga lartësitë 1700-1800 metra edhe të blejmë ujë, kjo ndodh vetëm në qeverisjen tuaj. Së fundi do të ndalem nga fshati i cili vij unë, ku para një kohe, para dy seancave ma ke ndërrue edhe vendbanimin, ke thënë nuk je banor i fshatit Zym. Pavarësisht, ne jemi banorë të gjithë dhe ne jemi asambleist, jemi të thirrur që të flasim për të gjithë nga komunitetet. Nuk më ke dhënë arsyetim, të kam vet edhe nga seancat e kaluara, për periudhën 2021-2025, për fshatin Zym i keni ndarë 120 mijë euro. Edhe pse kam bërë replikë që të ndahen më tepër, aq ke ndarë, nuk kam pas çka të bëj më tepër se nuk i kam gishtat. Nga kjo sasi e ndarë, as 50% nuk keni bërë investime. Keni fillue me një urë në fshatin Qollopek, vetmja urë e cila nëse shiqojsh tabelat e telekomunikacionit, është rrugë pa krye. E ke fillue deri aty, edhe jashta urës prapë nuk ka komunikim. Nuk ka lidhje, nuk ka qasje. Është bërë vetëm një gjërmim, është bërë vetëm një rrëmim i dobët, ku prapë nuk mund të qarkullojnë as automjetet e as makineritë, pikërisht bëhet fjalë për traktorë me të cilët duhet të bartin fshatarët edhe barnat, edhe drutë etj. Gjatë kësaj kohe shof vetëm investimet në murin Qollopek. Kryetar, ke harrue që Zymi nuk është Qollopek, por Qollopeku është Zym. Mbi 35 mijë euro për këtë mandat ke ndarë, urën, mure mbrojtëse. Po ku mbet fshati Zym? Gjatë kësaj kohe shof vetëm një 20 mijë euro kocka, kubëzime. Prioritet ke parë vetëm rrugën te xhamia, nuk është ai prioritet. Prioritet është krejt fshati me pas prioritet. Nuk ke ndarë para dhe nuk ke pas në planifikimin tënd buxhetor në pjesën e fushës, ku aty lidhet edhe aspekti i zhvillimit ekonomik. Aty jemi më në krizë, aty jemi më keq. Falë disa vullnetarëve, kemi qit nja dy drita nëpër fshat, po ndriçohet fshati. Ndoshta mund të jetë fshati i vetëm që asnjë dritë nuk e kemi fare. Te kanalizimet, drejtorin e kam këtu përballë meje, po më vjen mirë që e shoh, të

paktën 4-5 herë kam reague për një kanalizim. Nuk është ai vetëm i fshatit, por është i gjithë komunës që kalojmë aty pranë. Bëhet fjalë prej Stacionit të Autobusëve deri te trafa, e cila seriozisht po shkakton probleme të shumta, jo vetëm dimrit, por më e rrezikshme është verës. Edhe vjet ishte ekipi juaj bashkë me drejtorin e shikoi, do të bëhet për vjet, nuk u bo, do të bëhet sivjet, prapë nuk shoh unë aty që ka investime. Mbi 60 mijë euro ndamë në fillim të vitit 2021, kur e prune te klubi i Blaçit – se mo nuk mbet kush pa fol, po përzihem edhe unë pak, ndoshta edhe pak për fushatë. 100 mijë euro i ndamë, erdhi edhe donatori, edhe 100 mijë euro te donatori. 60 mijë euro na investime, ku kem mbrri, çka është në pyetje me to, kush shkoi ai donatori që i ofroi 100 mijë euro. Na prune këtu komplet klubin e futbollit, duke mendue që nuk do ta votojmë. Po ju, nga 27 asambleistë sa ishin, ju po më duket e keni marrë 29 gishta i keni ngrit, edhe dy vetë tjerë i kanë ngrit gishtat, krejt ishim për po. Ku mbet ai projekti, çka u bo me atë projekt, ku mbetën 100 mijë euro – se kolega Sefa tha do ta shfrytëzoj rastin për rritjen e deputetëve – me qeto punë të cilat nuk i ke krye, jo që do t'i rritni edhe dy, por do t'u humbni edhe dy. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit znjë Kryesuese, zonja dhe zotërinj, të nderuar asamblastë, të nderuar media. Para nesh kemi buxhetin për vitin 2026, i cili, për fat të keq, më duhet të vërej se është shumë diskriminues. Zotëri Kryetar, e di që nuk ju pëlqen ajo që unë them, por unë kam marrë letër e laps, kam parë të gjitha kolonat, kam llogaritur, llogaritur, llogaritur, dhe mua nuk më dalin shifrat. Ju, zonja dhe zotërinj, që e keni përgatitur këtë buxhet, na keni selektuar me kolonë të verdhë investimet kapitale për Gorën, në buxhetin që na keni dorëzuar. Kur i mblidhni të gjitha këto nga kolona e verdhë, del gjithsej 831.690 euro. 831.690 euro nga 3.715.990 euro përbën më pak se 22%, zotëri Kryetar. Në regjistrimin e fundit që u mbajt më 2024 në Komunën e Dragashit rezultoi se komunitetet jo-shumicë përbëjnë 29.25%. Nga 29.25%, kur e zbritni 22%, mungojnë plot 17%. Atëherë unë ju pyes: ku janë paratë? Përveç kësaj, zonja dhe zotërinj, ju në këtë buxhet na keni futur “vezën e qyqes”. Na keni selektuar investime kapitale që i përkasin Gorës, por në dy kolonat e fundit, nuk e di nëse e keni vërejtur ju kolegu Jonuzi, në investimet kapitale figuron shtrimi me kalldrëm i një rruge në fshatin Plavlje dhe shtrimi me kalldrëm i një rruge në fshatin Kapre. Fshati Plavlje, nga këto 22.38%, sipas buxhetit tuaj që na keni dërguar, do të marrë 8.000 euro, dhe Kapre do të marrë edhe 7.000 euro. Kur t'i zbritni këto nga 22%, ne biem diku pak mbi 20%. Zotëri Kryetar, juve mund të mos ju pëlqejë, por unë kam marrë letër e laps, i kam mbledhur të gjitha kolonat tuaja dhe kam parë se paratë nuk na dalin. Buxheti është totalisht diskriminues, propozimi i buxhetit i përgatitur për vitin 2026. Çështja e tretë, kolegu Jonuzi e tha

pak më parë se në draft-buxhetin për sanimin dhe renovimin e rrugës Dragash–Kukuljan ishin paraparë 100.000 euro, ndërsa tani ju në buxhet keni futur 15.000 plus 10.000 euro nga të hyrat vetanake. Zotëri kolegë, nuk e di çka nuk është e qartë këtu, por versioni përfundimtar i buxhetit është përgatitur këtu në bazë të votave të parashikuara që ata mund të siguronin, bashkë me tradhtarët tanë dhe satelitët e tyre që patëm rastin t'i shohim ditëve të fundit në media. Çështja e katërt, zotëri Kryetar, këtu keni paraparë 10.000 euro për asfaltimin e rrugës Stratorie–Bukë. Është ai rrugë që po e asfaltojmë tërë katër vitet. Kolegu Kurt disa herë e ka thënë nga kjo foltore se është shumë pak. Është ai rrugë për të cilën kryetarja e SDU-së, partnerja juaj në koalicion, u mburr se ju kishte sjellë 360.000 euro. Ku janë ato? Ju së bashku me të dolët në fotografi, u mburrët, u krekosët, se kishit sjellë 360.000 euro për ndërtimin e rrugës Zlipotok–Baçkë–Bukë–Brod. Ku janë ato? Dhe a do të përfundojë ndonjëherë ai rrugë deri në ditën e gjykimit? Ajo që më intereson më shumë këtu është: a është i njoftuar z. Uzair Hamza nga Zyra për Komunitete për këtë fakt që neve na mungojnë paratë në buxhet? Se ju, zotëri Kryetar, ose kush e ka përgatitur këtë buxhet, na keni prerë gati gjysmën e buxhetit.

Përsëris sërish, qytetarë të nderuar, para nesh është projektbuxheti për vitin 2026 ku për investime kapitale janë paraparë 3.715.990 euro. Nga këto 3.715.990 euro, kjo qeveri, së bashku me satelitët nga Gora që i mbështesin në gjithçka, ka paraparë për investime në Gorë, duke përfshirë edhe Dragashin si qytet multietnik, gjithsej 831.690 euro. Sipas çdo regjistrimi që të bazohemi, neve na mungon gati gjysma e mjeteve. Për më tepër, brenda atyre 831.690 eurove, qytetarë të nderuar, si “vezë qyqeje” janë futur dy fshatra nga Opoja që do të marrin 15.000 euro. Prandaj, kërkoj nga kryetari në largim që të vijë këtu në foltore e të na shpjegojë kush ia ka përgatitur këtë buxhet. Detyra ime është të kujdesem për të gjithë qytetarët e kësaj komune sa kohë që jam këtu në këtë sallë si asamblist, por detyra ime primare është të kujdesem për qytetarët e Gorës që, për fat të keq, janë lënë në mëshirë të kësaj qeverie në largim së bashku me satelitët tanë. Faleminderit.

Shpetim Hajredini: Përsëritje për të gjithë! Ndoshta sot është edhe seanca e fundit. E kemi edhe pikën më të rëndësishme të cilën duhet debatojmë, të paraqesim problemet dhe projektet të cilat janë për të mirën e qytetarëve. I dëgjova me vëmendje të gjitha diskutimet e kolegëve të mi. Të gjithë diskutuan për projektet kapitale, ndërsa për projektin i cili është ndarë specifikisht për drejtorinë nuk e preki askush. Ju e dini që gjithmonë, gjatë buxheteve të viteve të kaluara kam qenë kritik, profesional jam munduar të jem gjithmonë, korrekt, dhe asnjëherë nuk kam qenë fyes apo nënçmues. I nderuar drejtor, është një Propozimvendim, një buxhet, për mendimin tim, i përgatitur.

Nuk mund të them që nuk është mirë. Mirëpo, ndarja e cila është bërë nga paratë e taksapaguesve të Kosovës, për mu nuk është i duhuri dhe i cili është prit nga qytetarët e Komunës së Dragashit. Ti e din që edhe në vitin e kaluar apo edhe në vitet e mëparshme, sa jeni ju në ekzekutiv, kam kërkuar që të fokusoheni pak në drejtorinë e Bujqësisë dhe Blegtorisë, dhe kjo drejtori të ketë rritje të buxhetit. E pashë që këtë vit keni bërë një ndarje pak më të lartë buxhetore se vitin e kaluar – diku nja 30 a 40 mijë, se ish këtë vit pak më i lartë. Unë jam i bindur që kjo ndarje nuk është e duhura dhe nuk i plotëson kushtet dhe problemet e kësaj drejtorie, të këtyre qytetarëve të Dragashit të cilët ne i përfaqësojmë. Unë e di që sot, edhe po të propozoja është e kotë, sepse nuk i kam numrin i cili kërkohet për ta ndryshuar, por kish qenë mirë që ti vetë, personalisht, ta diskutoje me ekzekutivin dhe të kishe bërë një ndarje pak më të lartë në këtë drejtori. Gjithashtu, pashë se planifikimi urban veç projeksionin e keni ulur. Nuk e di tash pse e keni bërë një gjë të tillë. Kisha pas dëshirë të më japësh një përgjigje edhe për këtë çështje. Vazhdojme te Neni V, në programet buxhetore të prezantuara, Neni IV i këtij Vendimi, sipas Qarkores Buxhetore, nga Ministria e Financave, ku përcaktohen pagat dhe shtesat, 7 milionë. Po më intereson prapë tek subvencionet, e din që gjithmonë i preki këto. Prapë i keni lënë në 400 mijë. Nuk besoj që do të jenë të duhura dhe që i plotësojnë kërkesat e njerëzve të cilët janë në nevojë dhe kërkojnë që të ecin përpara me bizneset e tyre. Edhe pse ju e dini që unë pata kërkuar që edhe përmes Zyrës së Prokurimit, përmes projekteve të ndryshme, t'i ndihmoni fermerët e Komunës sonë. Por, natyrisht kemi pas mundësi t'i ndihmojmë edhe me forma të ndryshme, siç po i bëjnë edhe komunat tjera. Do të vazhdoj pak të diskutoj edhe për projektet, për disa projekte të cilat, për mu, nuk është dashur të ndahet buxhet për ato projekte, por së paku dua të marr edhe një përgjigje prej jush, se pse e keni bo një ndarje të tillë. Diçka që m'u duk e arsyeshme shumë edhe që është dashtë të bëhet shumë më herët. Tek numri rendor e kemi numrin 2 të projekteve, Fondi Rezervë i Komunës së Dragashit. Drejtor, të lumtë! Por, është dashtë ta bësh pak më herët, se përmbaruesi na qethi. Po edhe, sikur ta kishim pas mundësinë, ta kishim pas këtë fond buxhetor në ndarje buxhetore, edhe po të kishim pas ndonjë problem – siç ndodhi i vitit të kaluar nga vërshimet – do ta kishim pas shumë më lehtë t'ua kthenim në gjendjen e mëparshme qytetarëve dëmtimet. Për këtë e keni një bravo nga unë – pa marrë parasysh, ndoshta ti nuk vazhdosh pa 12 tetorit, por sido që të jetë, me rëndësi që është për të mirën e qytetarëve. Vazhdojmë tek numri 11, edhe pse po më duket se njëri prej assembleistëve e preki këtë projekt, por nuk e tha me numër rendor. Ndërtimi ndriçimit publik Dragash, Buqe, Zym, Zgatar, Pllajnik, Qollopek, Buzez, Brezne, rruga e varrezave, Xërxe, Zaplluxhe (Rrenak) qenka

veçanërisht e specifikume. Çfarë projekti është, drejtor, çka do të bëni me këtë? Shumë fshatra janë të përfshirë, ndriçim me 24,532 euro, s'un bëni send, nuk po e di çka është. Kisha pas dëshirë me më dhënë pak sqarim edhe për këtë projekt. Do të vazhdoj pak tek fshati im, fshati Kuk. Ju e dini që në seancën e kaluar unë e pata bo një propozim, nuk e keni marrë parasysh, nuk e kam parë këtu që e keni planifikuar. Prapë do ta bëj propozimin, edhe një herë, dhe po shpresoj që do ta kem mbështetjen e kolegëve asambleistë që të kalojë ky propozim, pasi që është nevojë e bashkëfshatarëve të mi që të realizohet ky projekt në vitin e ardhshëm. Ndërsa, kemi këtu tek numri rendor 20, ndërtimi i ujëmbledhësve në vendet ... s'po i lexoj, se tek e fundit ju nuk e dini, po bashkëfshatarët e mirë e dinë – në Kuk, Guri i Gatë, Te Del Uji, Gurost e Pordardhëm, qenka prapë i planifikuar, diku tri vite radhazi, prapë është. Ju kam thënë të tri vitet radhazi që fshati Kuk nuk ka nevojë për të, ka nevojë për një rezervoar më të ri me e bo, ka nevojë për filtrim të ujit, nuk ka nevojë për kaptazha dhe për gjëra të tilla, sepse buxheti nëse planifikohet për një gjë të tillë është i kotë. Nëse do jam unë pas 12 Tetorit, nuk do e lejoj që të shkojë kjo shumë në këtë projekt. Hapja, trasimi dhe kubëzimi i rrugës Kuk-Kosavë, tri vite në mos gabofsha, tri vite e di sigurt që u bo, së paku është dashtë të ndërrohet shënimi, hapja dhe trasimi, jo mo kubëzim, okej, në rregull jemi, edhe pse 88,860 euro janë të ndara për këtë rrugë, ku kemi shumë nevoja të tjera të fshatit të cilat është dashtë patjetër të ndahet shuma. Kemi kanalizimin i cili është tmerr edhe po kemi problem çdo ekzekutiv që po vjen. Si ne që kemi pas, si ju tash. Së paku është dashtë të ndahen dhe të fillojmë ta evitojmë këtë problem për çdo ekzekutiv që vjen mo. Ta largojmë këtë problem kyç, i cili është jetik për fermerët e fshatit tim. Andaj, unë nuk po vazhdoj, edhe pak kam me diskutue po këtu po e bëj propozimin. E kam kërkue, e din ti, edhe në evetnuale të seancës së kaluar, kam kërkue që 10 mijë – 15 mijë euro të jenë për ndriçimin e atyre rrugicave të fshatit të cilat janë pa ndriçim. Ndriçimi i fshatit Kuk është kryer nga banorët e fshatit, ma qartë që e kemi bo tubimin nga bashkatdhetarët dhe e kemi krye, mirëpo atëherë e kemi pas një kriter dhe nuk kemi hy shumë thellë, ndërsa tash është një kërkesë e tyre që duhet edhe në ato rrugica të kryhet. Prandaj, atëherë unë kërkova që të jetë projekt në vete, prapë po e kërkoj. Ju kisha lut, asambleistë të nderuar, që të ma mbështetni këtë propozim, pasi është për të mirën e bashkëfshatarëve të mi. Një projekt tjetër, i nderuar drejtor, që më ra në sy dhe nuk mujta me e kuptue se çka është. Numër rendor 42, fshati Pllajnik, a ka mundësi pak me ma specifikue, drejtor. Fshati Pllajnik ne e dimë, por çka ka me ndodhë me këtë fshatin Pllajnik. 58,461 euro ndarja është. Do vazhdojmë pak edhe tek arsimi dhe shkenca, edhe këtu e njëjta pyetje vlen, drejtor. Ma ke shënue qetu njëfarë numri rendor 1,

Bresanë. Edhe për këtë kërkoj që të më japësh sqarim, se çfarë projekti është ky, vetëm emri shënon Bresanë. Ndërsa numri rendor 2, ndërtimi i stadiumit dhe infrastrukturës përcjellëse, rruga e bjeshkës në Shajne, dhe pastaj keni vazhduar në fshatrat Kosavë, Bellobrad, Shajne, 20 mijë euro. Mundësisht, drejtor, më japish sqarim edhe për këtë, çka ka ndodhë, ta kem të qartë se çka ka me ndodhë me këtë projekt. Ju faleminderit për vëmendje, të marrim një herë përgjigje dhe pastaj shpresoj që të mos kem nevojë më për replikë!

Uran Halimi: Faleminderit, zonja kryesuese! Po të përgëzoj për këtë sjelljen kaq të mirë me ne! Meqenëse është edhe seanca e fundit, realisht unë në fillim nuk e shfrytëzoja aq shumë kohën, nëse nuk prish punë me m'ofruar pak kohë, përderisa është edhe seanca e fundit. Vazhdimisht kam hulumtuar edhe kam diskutuar për projekte, e sidomos të buxheti i vitit të kaluar, kam pas edhe propozime për ndarje buxhetore, nëse ju kujtohet. Së fundmi, kryetar, janë "rregull" ujëmbledhësat e fshatit Blaç. Kam qenë edhe vetë atje në vendpunishte ku është punuar aty. Një reagim që e ka bo PDK-ja, nuk e di a të ka ra në sy apo jo. Edhe vetë jam dëshmitar, edhe kam foto e video që, edhe pse janë kryer punimet atje, gypat e ujësjellësit vazhdojnë të qëndrojnë mbi tokë. Është bërë punim, nuk e di a ka mbikëqyrës aty, a ka kritere, menaxher të kontratave, mirëpo fshati Blaç vazhdon të përballet me mungesë të ujit të pijshëm dhe papastërti, e punimeve jo të mira që janë bo. Ju ftoj, nëse keni kohë, të shkoni edhe vetë ta shihni aty, janë marrë disa njerëz sa për foto, duke i shfrytëzuar që kishte është punuar diçka, a në realitet nuk është punuar asgjë aty. Me pas pak përgjegjësi morale është mirë, kryetar, me shkue edhe vetë me e pa atë pjesën. Tash deshta të ndërlihem te pika e 13-të, e kemi asfaltimin e rrugës Blaç-Bjeshkë dhe Blaç-Shtavë. Në planifikimin buxhetor të vitit të kaluar, ka qenë rruga e Shtavës e planifikuar, nuk është bo kurgjo. Ju e dini që unë kam propozuar edhe të Ura e Haxhisë aty, me filluar punimet, kemi ndarë një vlerë prej 14 mijë eurove, që me iu lehtësuar atij qytetarit aty përtej lumit që nuk ka infrastrukturë as rrugore, e as ndriçim, e asgjë aty. Mirëpo, Bile, herën e fundit kur ta kam pyetur, kryetar, ke thënë që ka me u hap tenderi qetash për me u bo ajo rruga. Prita një muaj, dy muaj, besoj që janë bo ma shumë se 3-4 muaj edhe nuk kam pa tender, e as punim, përveç kubëzimit të disa oborreve për kalkulime politike. Te tjetra, e përmendi edhe Driton Ademi, tha që te ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg janë ndarë edhe 20 mijë euro. Ka qytetar që ankohen për mungesë të ndriçimit publik, atje diku sipër në Kuklibeg. Është ankuar publikisht edhe në Facebook. Mandej një ndarje buxhetore, rehabilitimi i rrugëve lokale në rajonin e Opojës, janë ndarë diku 20 mijë euro. Me 20 mijë euro nuk e di çka keni me rehabilituar. Një vlerë që më çuditi është 45 mijë euro ndriçimi

publik në qendër të fshatit Pllavë. Unë e di që është krye ndriçimi publik në Pllavë. Tash edhe 45 mijë euro, veç si t'ia ndërroni ngjyrat. Mandej, te fshati Pllajnik – bile i thashë edhe drejtorit – fshati Pllajnik nuk ka planifikim, veç janë të ndara diku 58 mijë euro. I thashë a keni me jau dhënë CASH atyre qytetarëve, a qysh është puna me ato 58 mijë euro. S'e di çka po bëhet. Është kolona numër 42, i nderumi kryetar. Një ndarje tjetër buxhetore te arsimi edhe shkenca, po e shoh te kolona e dytë, ndërtimi i stadiumit, infrastrukturës përcjellëse (rruga e bjeshkës në Shajne), në fshatrat Kosavë, Bellobrad, Shajne. S'po e kuptoj, është fjala te arsimi edhe shkenca, ndarja buxhetore, përveç stadiumit edhe infrastrukturës përcjellëse, po shkrun rruga e bjeshkës në Shajne që s'ka të bëjë me arsimin kjo. Është mirë nëse bëhet rruga e bjeshkës në Shajne, po...

Arijeta Skeraj: Uran, a ke ndonjë propozim? Veç propozim konkret mundesh me dhënë, se po i kaloj gati gjashtë minuta.

Uran Halimi: Patjetër! Atëherë, propozim i imi është që të rishikohet edhe një herë rregullimi i kaptazhave, që ka qenë kërkesë e vetme e qytetarëve. Është bërë dy herë, edhe vlera ka qenë shumë e majme. Në vitin 2022 ka qenë diku rreth 40 mijë euro, prapë është hap tender, prapë janë investuar edhe 40 mijë euro edhe nuk është bërë kurgjo. Propozoj që të rishikohet ky tender. Tjetra është, propozoj ndarje buxhetore, propozoj që, përveç rishikimit të këtij tenderit, që në Blaç të rregullohet, të ndahen mjete për rregullimin e asaj pjese te ura e Haxhisë. Vjet kanë qenë 14 mijë euro, tash më së paku duhet me qenë qato edhe ndonjë shtesë në qoftë se është e nevojshme. Nuk janë 14 mijë euro që i kemi votue si buxhet na vitin e kaluar. Propozim tjetër e kemi në fshatin Brezne. Duhet të bëhen patjetër investime në zonën e liqenit edhe te stadiumi. Nuk ka edhe ndriçim publik aty. Si munden me u zhvillue turizmi, pa ndriçim?

Arijeta Skeraj: Konkretisht çka aty te fshati Brezne?

Uran Halimi: Ndriçim nuk ka. Ndriçimi publik duhet me u bo gjithqysh aty. Te fshati Pllajnik, meqenëse nuk ka destinim të mjeteve, unë propozoj që të bëhet hapja dhe rregullimi i rrugës bujqësore, nga Cyleni për në bjeshkë. Bujqit e fshatit Kosavë vazhdimisht e kanë bërë këtë kërkesë. Domethënë, prej kësaj pjesës që është vlera 58 mijë euro, propozoj që të ndahen mjete për rregullimin e rrugës nga Cyleni për në bjeshkë. E kemi edhe një propozim tjetër në fshatin Bellobrad. Ai amfiteatri i famshëm kurrë s'është përfundu, edhe propozoj që në Bellobrad të finalizohet amfiteatri i lënë përgjysmë. Zaplluxhja, meqenëse keni parapa në buxhet kubëzim, unë propozoj që në Zaplluxhe të bëhet edhe zgjidhja e kanalizimit në Tumqinë edhe Rrenak. Ata nuk kanë kanalizim. Ju e dini qysh është gjendja. Propozoj që në fshatin Blaç të bëhet pastrimi i shtratit

të lumit i cili është në gjendje të mjerueshme. Aty munden me pas ndonjë epidemi e sëmundje, ruajna Zot, ngjitëse ose ku e di qysh. Pse të mos ketë trotuar në Mejdan të fshatit Kapre, kur hapësira ka. Rruga e Kapres duhet të ketë trotuar, meqenëse aty kalojnë nxënësit vazhdimisht. Propozoj që të bëhet trotuari nga Mejdani për në fshatin Kapre. Në fshatin Brrut, i nderum Gazmend, ke bo shumë foto, po më pëlqen, unë propozoj që të bëhet ndriçimi publik në lagjen poshtë atje, në fushë. Pse mos të kenë edhe ata ndriçim publik?

Arijeta Skeraj: Atëherë, Uran, këto kërkesat tjera ia dërgojsh kryetarit, se veç e ke kalue minutazhin ma shumë se çka duhet!

Uran Halimi: Të nderuar qytetarë, kam pas edhe kërkesa tjera, mirëpo po më pamundësohet!

Arijeta Skeraj: E ke pas minutazhin në fillim. E dyta herë, ti gjithmonë ke thënë rregullave me iu përmbajt, kjo është rregulla që duhet me iu përmbajt. Atëherë, edhe unë e kam një kërkesë prej fshatit Pllavë, që më është drejtuar mu për një mur mbrojtës. Dua që ta lus kryetarin, për stadionin e fshatit Pllavë, ku e kam pas edhe një takim me banorët e fshatit Pllavë, unë e di rrjedha edhe qysh ka me shkue, por ata dojnë me e ditë prej kryetarit të Komunës se çka do të ndodhë me stadionin e fshatit Pllavë.

Samidin Xheladini: Ju përsëndes të gjithëve edhe ju uroj sukses të gjithëve, ishalla të gjithë fitojnë, por gjashtë vetë ma pak kemi me qenë. Edhe bartësit e listës, domethënë për gjashtë vende na burrat luftojmë. Gjashtë gratë, mjaftojnë. Ishalla fitojmë krejt, por s'ka shancë. Kështu, deshta me e bo një diskutim të përgjithshëm. Unë, qe 16 vjet po i bëj në Asamble, buxhetin e investimet i kam votue, pa marrë parasysh dallimet politike, partiake, lokale, nacionale etj. Unë edhe mburrem, më vjen mirë që kam arrit që me votue, se e kam pa prej fillimit e mbarim se investimet që bëhen në Komunë, pa marrë parasysh, duhet të shfrytëzohet mundësia të votohen dhe të realizohen. Kjo qeveri i ka realizue të gjitha investimet që i ka pas në Buxhet, qeveritë e kaluara e kanë dështuar gjysmën e Buxhetit, krejt e kanë çue në suficit, edhe ma tepër se gjysmën. Nuk due me akuzue e me bo propagandë, politike. Po më vjen keq për disa parafolës, që nuk po ua përmendi emrin, të cilët kanë kërkue ujësjellës, ujin shumë herë e kanë përmend. Kur ka dalë propozimi milionësh për ujin, kanë votue kundër. Është për keqardhje! Nuk due me ia përmend emrin, se mandej kur të hup thotë ai i ka pas fajet. Jo ty, nuk e kam me ty. Nuk përmendi emër! Ne jemi një brum, pa marrë parasysh ku jetojmë. Nuk ka të bëjë këtu me ndarje territoriale, nacionale, vendbanime etj. Gjithmonë qekjo qeveri ka investue, unë mendoj, më së miri, edhe me ardhë kush me ardhë në pushtet nuk ka mundësi me investue. Nuk kanë bo diskriminim. Një parafolës, një i

afërm i jemi, thojke çdo investim që u bo në lokalitetin e tij kundërshtojke, pse po bëhet kështu e pse po bëhet ashtu. Sot po ankohet se nuk po bëhet investim aq i duhur, në lokalitetin e tij ku jeton ai. Edhe unë jetoj aty. Driton, po ta përmendi emrin, se ti nuk ke me qenë anëtar i Asamblesë, ti nuk hupish. Ke bo propaganda të tmerrshme, po bëhet kështu në Bresanë, po bëhet kështu në Bresanë. Tash po thuesh pse s'po bëhet në Bresanë. U çudita! Po më vjen mirë. Tjetra, kemi pas edhe raste këtu në, për katër vite, kur propaganduesit kanë bo propagandë se kryetari, pse është i lokalitetit Bresanë, po investon vetëm në Bresanë, ndërsa nëpër fshatra tjera iu thojnë që po investojnë në Bresanë, ndërsa bresanasve po të njëjtit iu thojnë kurgjo nuk po bëjnë në Bresanë, po i çon paret atje, e atje. Këto forma janë shumë të ulëta. Ia kam dhënë besën Dritonit me e thënë një gjë për një person që ai e di. Ka shkue ia ka lyp votat dikush dikujt, ia ka lyp votat babës Dritonit votat me ia bo për Shaban Shabanin – qe po kallxoj – edhe ka thënë nuk ia qes votën Shabanit, ka thënë po djalë i mirë, po s'kemi m'i nxjerr nuse Shabanit. Djale i mirë, nuse s'nxirret, duhet me punue. Duhet me punue këtu, o Driton Ademi. Rahmetlia ka lënë fjalë, ai nuk është për m'i nxjerrë nuse, po me punue. S'ka punue kurgjo, nuk ka bo kurgjo.

Driton Ademi: Samçe, po të përmendi emrin – nëse duesh edhe del – po duhet me u mburr për atë që ka qenë, sot është i ndjer prindi im. Pa marrë parasysh çka ka thënë ai. Unë veç po të llogariti edhe po të foli me statistika, edhe kam qenë në gjendje me ta thënë publikisht. Nëse nuk e dinë shumica e anëtarëve, edhe në media është këtu, të kam marrë ty edhe Xhylferien edhe kam qenë te kryetari. Le ta pranojë kryetari, edhe të kam pyet a duhet investime, a duhet diçka me ndryshue për Bresanë. Nuk e di qeto investime kapitale, kush është duke u pyet ne Bresanë. Qe unë po të them – e përmendën shumë kolegë – te arsimit edhe shkenca, Bresanë. Me qëllim, o Samidin Xheladini, me qëllim e ka shkruë Bresanë, 23,900. Pse? Në Kornizë Afatmesme e ke ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzim, demolim, A je duke e kuptue? Demolim e kie në shkollën fillore “28 Nëntori” në fshatin Bresanë. Nuk e kanë shkruë, qekjo është përrallë. E treta vjet është demolimi i shkollës. Hi kqyri, prej 2023-tës e kie, e treta vjet është. Nëse ti mendojsh që unë jam duke folë keq. Qysh qaj kod është? Nuk mund me qenë arsimit qaj kod. Pllajnik, veç e ka shkruë fshati Pllajnik. Çka kie me investue? Unë nuk e di qysh. Shpeta po kërkon me ia mbështet, edhe disa tjerë kërkuam me ia mbështet. Unë nuk e di qysh munden me u mbështet qeky buxhet është mirë me u mbështet, nuk jam kundër për mos me u mbështet. Por, nuk e di qysh munden me u mbështet kur e shkrujsh veç fshati Bresanë. Edhe kapni edhe m'shitni moral mu këtu. Qysh mundeni me m'shit ju mu moral, qeverisje që keni punue. Nashta me letra po, jam i bindur, dorën në zemër, me

letra ju jeni të parët për atë. A sa për me dalë për punë, çka keni bo nëpër fshatra, ky është tmerri më i madh në Kosovë bën vaki. Ju keni mund me e harxhue buxhetin, por tmerri më i madh është në Kosovë. Edhe plus te e dyta po ta lidhi, te ndërtimi i stadionit me infrastrukturë përcjellëse. Ku ke pa bre ti, rruga e bjeshkës Shajne, në arsim rrugë të bjeshkës – e përmendi Urani – ku ke pa ti rrugë në arsim? Kjo është marri bre. Edhe po thoni me e votue këtë buxhet, a? Po jo bre, çfarë edhe ti!

Bexhet Xheladini: Të nderuar, së pari në fillim duhet t'ju përshëndes të gjithëve! Ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pasur gjatë këtyre katër viteve. Unë jam jashtëzakonisht i kënaqur me punën tuaj dhe me bashkëpunimin që kam pas me ju. Ndoshta kjo është Asambleja e fundit për këtë mandat. Pa humbur kohë, dua që të kaloj në përgjigjet e pyetjeve që i kanë bërë delegatët. U përmend ujësjellësi në fshatin Shajne, ai është i përfshirë edhe ai do të bëhet me buxhetin e vitit të ardhshëm, aty ku ka nevojë. Shumë asambleistë e kanë përmend pse janë bërë shkurtimet buxhetore në mes dy miratimeve të buxhetit. Unë që nga viti i dytë kur e kam marrë mandatin, kam kërkue që të na lejojë Ministira të krijojmë një kod të posaçëm, një fond rezervë, për pagesën e kontratës kolektive, për arsye se pagesa e kontratës kolektive ka qenë edhe premtim elektoral i imi para katër viteve. Nuk na ka lejue, edhe në miratimin e parë të buxhetit Minsitria nuk e ka lejue këtë kod, mirëpo me kërkesën e Qamil Kollonit në disa takime që i ka pasur me përfaqësues të ministrisë, ka kërkue me ngulm që t'u lejohet komunave ta krijojnë një fond rezervë. Kështu që ne, pas propozimit të parë kemi bërë disa shkurtime në shumë projekte, në mënyrë që ta krijojmë një shumë prej 200 mijë eurosh, dhe këtë shumën e kemi bërë si fond rezervë për pagesën e kontratës kolektive për vitin e ardhshëm. Ne jemi kah fundi i pagesës së kontratës, kështu që vitin e ardhshëm mendoj se muajt e parë të vitit do të përfundojë pagesa e kontratës kolektive. U përmend se me pak mjete janë paraparë ndriçim publik në shumë fshatra të pjesës së Opojës. Ne jemi prapë fitues të Grantit të Performancës, vetëm nuk e dimë shumën dhe kemi planifikue që të gjitha mjetet që i takojnë komunitetit shumicë t'i orientojmë në ndërtimin dhe përfundimin e të gjitha ndriçimeve publike në të gjitha fshtarat të cilët nuk kanë ndriçim. Por edhe në fshatrat edhe lagjet ku kanë mbet pa u instalue ndriçimi publik, do t'i bëjnë të gjitha. Këto mjetet prej 24-25 mijë euro që i kemi paraparë, janë mjete vetëm për participim. Mjetet që do të na takojnë neve nga Granti i Performancës, do t'i orientojmë në ndërtimin e stadioneve nëpër fshatra të pjesës së Opojës, edhe të ndriçimit publik. U përmend pse ka mjete për ndriçim publik në fshatin Kuklibeg edhe Pllavë. Ju e dini që ndriçimi publik në fshatin Kuklibeg edhe Pllavë janë projekte dyvjeçare.

Këtë vit që shkoi ne kemi pas mjete të parapame, edhe për Pllavë, edhe për Kuklibeg. Punëkryesi i ka krye punimet edhe pret që mjetet t'i marrë vitin e ardhshëm. U përmendën edhe disa propozime në fshatin Zgatar, ju e dini që në fshatin Zgatar është projekti i kubëzimit të rrugëve edhe i mureve mbrojtëse, është projekt dyvjeçar. Projekti ka filluar vitin e kaluar, është duke vazhduar ky projekt edhe këtë vit, dhe besoj që brenda 10 ditëve ky projekt përfundon, edhe kubëzimi i rrugëve që kanë qenë të parapara me tender, edhe ndërtimi i mureve mbrojtëse. U përmend edhe trashëgimia kulturore. Ju e dini që nuk është kompetencë e Komunës, është e Ministrisë. U përmend edhe Stacioni i Autobusëve. Ne e kemi parapa që ajo pjesë, bile me Ministrinë e Infrastrukturës, unë së bashku me zëvendësinministrin kemi nënshkruar një memorandum, që Ministria ta bëjë asfaltimin edhe rregullimin e asaj pjese, por kjo nuk është bërë, edhe pse disa herë kam insistue edhe kam kërkue. Mirëmbajtjen e parqeve në Dragash, e kemi në kontratë me Ekoregjionin. Sefidin Mejzini përmendi ndryshimet që janë bërë, unë i tregova pse janë bërë këto ndryshime. Prej shumë projekteve i kemi marrë mjetet, vetëm me e krijuar fondin rezervë. Ndriçimi publik është i paraparë në fshatin tuaj, edhe rregullimi i stadionit, në këto projektet e përbashkëta nga Granti i Performancës. Gjithashtu, rruga e bjeshkës është në buxhetin e vitit të ardhshëm. U përmend muri mbrojtës në fshatin Kapre. Kur përmendet kubëzimi, aty përmendet edhe infrastruktura përcjellëse, kështu që ne mujm me e parapa këtë mur mbrojtës, nuk është kurrfarë problemi. Suada Bajrami ka qenë bashkë me kryesinë e fshatit tek unë në një takim, dhe të gjitha ato propozimet që i kanë paraqit ne i kemi paraparë në buxhetin e vitit të ardhshëm. Edhe rrugën deri te bazeni me u kubëzue, edhe rruga për bjeshkë, të parapara. Për Zgatar u përmend shpronësimi, se mos është bërë nga buxheti i fshatit Zgatar. Jo, nuk është bërë nga buxheti i fshatit Zgatar, por shpronësimi u bë nga buxheti i përgjithshëm i mjeteve që i takojnë komunitetit shumicë. Për pompat, ka qenë një person i ka kontrollue pompat, ato janë aktive, janë në punë, dhe nuk ka nevojë me harxhue pare shtesë për rregullimin e tyre, sepse ato janë duke punuar. Në Gjerman u kërkua të bëhen disa investime dhe pastrimi i deponive ilegale. Ne e kemi bërë një herë një pastrim aty, por prapë njerëzit po gjuajnë. Është normale që ne tabelë duhet të vendosim dhe kemi vendosur çdokund afër 50 tabela në të gjitha lokalitetet e Komunës sonë, që të ndalohet hedhja e mbeturinave, mirëpo qytetarët prapë – ndoshta ata nuk janë qytetarë të Komunës sonë, por po vijnë edhe nga viset tjera dhe po i gjuajnë ato. Është kërkue nga fshati Zgatar ta çojmë një kontenier, e kemi çue kontenierin e ri atje. Ndriçimin publik në Zgatar: Unë e di që në Zgatar ndriçimi publik ekziston, jo në të gjitha vendet, por megjithatë ekziston, por ky është i lidhur nëpër shtëpi. Kështu që, në buxhetin e vitit

të ardhshëm, në projektet e përbashkëta e kemi paraparë që te ky ndriçim të rregullohet dhe të fillojë edhe pagesa e shpenzimit të ndriçimit publik nga Komuna. Gjithashtu, ne kemi marrë edhe një vendim, që edhe shpenzimet e rrymës për pompat e ujit të bëhen nga Komuna, jo vetëm për Zgatarin, por për të gjitha fshatrat e Komunës së Dragashit. Artani ka pyet pse nuk janë drejtorët këtu. Drejtorët, kur është kryetari, nuk është e domosdoshme që me qenë ata këtu. Ndërtimin e deponive të ngurta e kemi heq nga propozimi i parë, dhe tash në buxhetin e vitit të ardhshëm nuk ka edhe mjete të parapara, edhe nuk është e paraparë që të ndërtohen këto deponi. Sa u përket ndërtimit të kulmeve, është projekt trevjeçar. Është e vërtetë që në vitin e parë kemi paraparë më pak mjete, por në vitin e dytë dhe të tretë kemi paraparë mjete të mjaftueshme për renovimin e kulmeve dhe të ndërtesave – unë e di që janë pesë ndërtesa, këtu u tha që janë më shumë, por me sa e di unë janë pesë. Muri mbrojtës në Rrenc, nga 68 mijë ka ra në 60 mijë, unë tregova pse janë bërë këto shkurtime. Është dashtë atë 200 mijë euroshin me e nxjerrë nga shumë projekte. Ndërtimi i terreneve sportive në Libevishtë, është fjalë për ndërtimin e një stadioni, por ndoshta është shkruar në shumës, është gabim. Renovimi i QMF-ve dhe AMV-ve në pjesën e Gorës, unë mendoj që janë të mjaftueshme këto mjete, për arsye se nuk ka nevojë shumë me bo renovime, por ka renovime të vogla, renovime të brendshme. Ndërtimi i stadionit në fshatin Blaç, e dimë se si ka rrjedhë procesi. Në momentin kur e kemi marrë vendimin, kemi pas një investitor apo donator, i cili ka qenë edhe kryetar i KF “OPOJA”. Mirëpo, ai pastaj ka pas probleme financiare me kompaninë që e ka në Austri, edhe ai është tërhequr si investitor apo donator i stadionit, dhe ne tash e kemi marrë, Komuna, që vitin e ardhshëm ky stadion të përfundojë dhe janë të ndara mjete të mjaftueshme për ndërtimin e tij, dhe gjithashtu tenderin e ka marrë një kompani dhe ka me fillue punën edhe sivjet edhe në mot, edhe ky stadion kryhet. Sa i përket përqindjes së ndarjes së drejtë financiare. Në bazë të regjistrimit të fundit, diku afër 40% në Komunën e Dragashit jetojnë komuniteti joshumicë, ndarja e drejtë financiare është fiks 40%. Kështu që, kush mendon ndryshe e ka gabim, ose e thotë për qëllime elektorale, ose e thotë që nuk e di matematikën. Rruga Dragash-Kukajan, unë e kam marrë një telefonatë nga Ministria e Infrastrukturës, edhe ka thënë që mos ndani mjete për këtë rrugë se do ta ndërtojmë ne. Edhe urën, jo vetëm rrugën. Kështu që, ne kemi paraparë mjete vetëm për infrastrukturën përcjellëse edhe trotualet. Unë propozoj që te pozicioni 64, ku është fjala për të hyrat vetanake në vlerë 9,728 euro nga fshati Krushevë, të hiqen ato mjete dhe të qiten në rregullimin e ujësjellësit në fshatin Glloboqicë. Nexhati e përmendi satdionin e Pllavës, ne për atë kemi folë shumë. Por, ky stadion do të përfundojë. Janë ndarë të gjitha mjetet e nevojshme, do të

përfundojë sipas projektit që është bo. Një kompani vendore e ka marrë me e krye punën. Ajo ia ka fillue, është duke punue dhe, sipar informatave të para që i kemi, kompania është duke punuar mjaft mirë dhe punën është duke e kryer me kualitet. Ajo nuk është duke punuar vetëm për stadionin, por është duke e rregulluar edhe hapësirën përreth stadionit. Unë ditën e enjte i kam pas përfaqësuesit e fshatit Pllavë, dhe kanë ardhë e janë falënderue për punën që është duke u bërë në stadion, edhe rreth stadionit kompania është duke i krye punët dhe duke e rregullue rrethin, edhe hyrjet nëpër rrugët e Pllavës. Investimet në Dragash, është e vërtetë që nuk janë bërë investime të mjaftueshme në Dragash, por me buxhetin e viteve të ardhshme trevjeçare që i kemi paraparë, vëmendja më e madhe do të jetë në Dragash, në krahasim me të gjitha lokalitetet, sidomos në infrastrukturë rrugore, ujësjellës dhe kanalizim. Për ujin në Dragash u fol, ju e dini që uji në Dragash nuk është kompetencë e Komunës. Është kompetencë e Hidroregjionit, po megjithatë ne kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me Hidroregjionin, dhe ne kemi ndarë mjete financiare, dhe me bashkëfinancim kemi investuar në ujëmbledhësin edhe në koagulatorin i cili bën koagulimin e ujit, dhe prej atij momenti është ndryshue edhe kualiteti i ujit të Dragashit është më i mirë sesa para se të investonim ne. Në Zym – profesori ka bo edhe ma herët pyetje për shumën e mjeteve që janë ndarë dhe investimeve – unë, në njërën nga seancat e kam dhënë këtë përgjigje por profesori nuk ka qenë aty. Kështu që, mund t’i merr shënimet edhe t’i shoh përgjigjet e mia në mjetet e informimit. Projektet e Zymit, kubëzimet dhe muret mbrojtëse, tenderi është duke ecur dhe të gjitha ato që kanë qenë të parapara do të ndërtohen. Përveç infrastrukturës, kubëzimeve dhe mureve mbrojtëse, do të bëhet edhe ndriçimi publik në fshatin tuaj. Pse është vonuar ndriçimi publik, arsyeja është se nuk ka pasur deri më tash kërkesë. Kërkesa ka ardhë edhe tash është planifikue me buxhetin e ardhshëm që të bëhet edhe ndriçimi publik. Njëri prej delegatëve bëri zhurmë shumë për ndarjen e drejtë. Nuk është e vërtetë që ne nuk kemi bërë ndarje të drejtë. Ndarja e drejtë është 40%. Kush nuk beson, le ta formojë një komision, le ta vlerësojë, është shumë gabim me dalë këtu me e dezinformue opinionin. Personi në fjalë, vazhdimisht, qe katër vite mundohet me bo ndarje, ndasi në mes të tri komuniteteve që jetojnë në Komunën e Dragashit. Qëllimi i tij është ky, me bo ndarje nacionale. Për rrugën e Kukajanit e dhashë përgjigjen. Stratorie BUKA, 10 mijë euro. Është rrugë tjetër, është rruga e cila shkon pran stadionit edhe e lidh në formën më të shkurtë rrugën Zlipotok-Brod. Edhe sivjet ajo rrugë ka me u asfaltue një pjesë, edhe vitin e ardhshëm i kemi paraparë 10 mijë euro si participim, dhe me mjetet e Grantit të Performancës që do t’i takojnë komunitetit joshumicë, do të ndahen mjete të mjaftueshme për asfaltimin e asaj

rrugës. Ndërsa, u përmend Duda, këtu janë bërë fotografi etj. Kjo nuk është e vërtetë që una kam bërë me Duden fotografi për këtë çështje. Janë ndarë nga Ministria e Infrastrukturës 360 mijë euro, është projekt trevjeçar, por jo për këtë rrugën që e pate fjalën, sepse nuk ke informata edhe nuk e ke lexue mirë materialin. Është fjala për rrugën Zlipotok-Brod. Një pjesë e mjeteve janë shpenzuar këtë vit, edhe vitin e ardhshëm, edhe vitin tjetër edhe ato mjetet tjera, edhe ajo rrugë do të përfundojë. Kryesuese, të kisha lut me e bo edhe një propozim tjetër. Propozoj që 10 mijë euro nga subvencionet e kryetarit të hiqen dhe të qiten në subvencionet për bujqësi, dhe 20 mijë euro nga kultura të hiqen dhe të qiten subvencione në bujqësi. Dhe, nga viti i ardhshëm do të fillojmë edhe subvencionimin e mjedrës. Ishte një kërkesë e Shoqatës së Afaristëve gjatë mbajtjes së panairit. Kështu që, në vitin e ardhshëm do të fillojmë edhe subvencionimin e mjedrës. Prapë kishte pyetje edhe për fodnin rezervë, unë e dhashë përgjigjen pse e kemi bo edhe ku i kemi marrë mjetet. Ndriçimi nëpër rrugica, do ta bëjmë tash, e dhashë përgjigjen. Për Pllajnik është fjala për projekt dyvjeçar, është fjala për ndërtimin e disa mureve mbrojtëse në fshatin Pllajnik, edhe muri mbrojtës te varrezat. Gjithashtu, edhe një pjesë e mjeteve janë të parapara për kubëzime. Por aty, kur është bo shtypja është hek ai emri i projektit. Kryesuese, shënoje, për Pllajnik vërejtjet e delegatëve janë me vend, kish mbet veç fshati Pllajnik, të shënohet ndërtimi i mureve mbrojtëse te varrezat dhe në vendet më të ekspozuara të fshatit, si dhe kubëzimi i disa rrugëve të mbetura – është titulli i projektit. Në pozicionin 11, prapë u përmend ndriçimi publik, 24 mijë euro, tash këto mjete janë për bashkëfinancim. Sepse ndriçimin publik e kemi paraparë mjete nga Granti i Performancës. Ujëmbledhësit – unë e di që, sa i përket ujëmbledhësve ke bo shumë zhurmë në çdo Asamble, bile lëndën e kishit pas çue në prokurori. Prokurpria jau ka kthye prapë, nuk ka elemente për ngritjen e aktakuzës. Nëse doni, dërgone prapë. Unë e di që projekti i ujëmbledhësit ende nuk ka përfundue, është në proces e sipër. Komisioni për Pranimin e Punimeve ende nuk është bërë. Kur të përfundojë ky projekt, ke me e pa, por megjithatë, aty është bërë një punë shumë e mirë. Unë i kam parë, s'kam nevojë me shkue. Kanë qenë zyrtarët komunalë, i kanë parë ujëmbledhësat, i kanë bërë fotografitë, i kanë shikue punimet si janë bërë. Në bazë të fotografive edhe ujit që po vjen në rezervare, po shihet që uji po vjen i pastër, shumë më i pastër se që ka qenë më herët. Ndërsa, pse po ndihet mungesa e ujit, ju e dini që disa muaj nuk ka rënë shi, janë shterrë edhe vijat, lumenjtë dhe burimet. Por, megjithatë, kam marrë informata se në në Mahallën e Naltë, pas shtimit të ujërave u rrit shtypja edhe në tri vende, ka pëlçit gypi. Nuk e di a i kanë sanue këto pëlçitje, por me sanimin e këtyre sigurisht se ujë do të ketë, edhe ka Blaçi ujë të mjaftueshëm. Në bazë të

reagimeve që janë bo, dikush nga personat që e ka qit se ka mungesë të ujit, vërehet se 90% e njerëzve kanë reague pozitivisht, kanë thënë ka ujë edhe uji është i pastër. Mjetet që u propozuan për hapjen e rrugës nga Cyleni për Bjeshkë, që Pllajniku i thojnë Fushë – unë dua të falënderoj KFOR-in Turk edhe Njësinë e LMT-së në Dragash, dhe të gjitha institucionet turke që janë të vendosura në Kosovë, që kohëve të fundit janë duke u punuar masovikisht në Komunën e Dragashit, pas trasimit të rrugës së Rrencit, kanë fillue edhe trasimin e kësaj rruge, rrugën për Bjeshkë. Pas përfundimit të saj do ta bëjnë edhe trasimin e rrugës për Pllavë edhe prishjen e shkollës në fshatin Bellobrad. Pastaj do të kalojnë në pjesën e Gorës, në pjesën ku ka shumë kërkesa. Sa i përket finalizimit të amfiteatrit, ndoshta zotëriu që e bëri këtë propozim nuk e di, por ndoshta edhe e di, por don me tregue se ja unë porpozova edhe ky po bëhet. Amfiteatri është duke u bërë me projektin e MZHR-së dhe ai do të përfundojë, ndoshta deri kah fundi i muaji. Unë sigurisht kam mbet borxh diçka, të kisha lut me m'i tregue çka është fjala. Ne për fshatin Brezne, për kubëzim i kemi paraparë afër 400 mijë euro vitin e ardhshëm me e bo, edhe në kuadër të këtij kubëzimi është edhe qaj muri. Është një mur që po e rrezikon rrugën dhe është i paraparë m'u ndreq. Është brenda projektit. Edhe ju i patët dy kërkesa, njëra ishte për një mur mbrojtës, ai është i paraparë brenda këtij viti. Edhe vitin e ardhshëm ai muri mbrojtës në Pllavë, bashkë me kubëzimet. Për stadionin e fshatit Pllavë e dhashë përgjigjen. Sa u përket kërkesave tjera që janë bo, për trotuaret, thashë që në atë pjesë nuk ecin më, se na e bëjmë transportin e nxënësve qe tri vite, edhe transportin e nxënësve të Kapres. Faleminderit!

Xhyferie Bahtijari Beqiri: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje të veçantë për kolegun tonë të ri, z.Nexhmi Dauti! Dua të vazhdoj me shprehjen e profesorit Nexhat, e cila më pëlqeu jashtëzakonisht shumë, që ne si përfaqësues po mundohemi që zakonisht t'i plasojmë kërkesat dhe nevojat e fshatrave ku ne jetojmë. Mendoj edhe unë, gjithashtu i bashkëngjitem këtij mendimi, se duhet të jemi pak më gjithëpërfshirës. Duke u bazuar në këtë, në mesin e listës së shpenzimeve, siç edhe e keni pa, i kemi disa kënde të lojërave, të cilat do të vendosen njëri në Zaplluxhe, dhe njëri në një fshat tjetër. Këndin e lojërave në Zaplluxhe e kam kërkuar unë, në mahallën “Te Xhamia” . Dhe, për ta përmirësuar dhe vetveten time, do të mundohem të jem pak më gjithëpërfshirëse dhe të kërkoj nga kryetari që, në mesin e punëve të mira që i ka bërë deri më tani, të vazhdoj edhe të bëj, që në të gjithë fshatrat të ketë kënd të lojërave për fëmijë, duke u bazuar në faktin se në shumicën e fshatrave veç kemi kënd të lojërave. Zaplluxhe, Blaç, Bresanë, Kuk, Bellobrad, duke u bazuar në atë që shumica e fshatrave veç ka

kënd të lojërave, të vazhdojë edhe në fshatrat që po mungojnë dhe të bëjë këndin e lojërave. Ndërsa, sa i përket zhurmës, që unë mund ta quaj si sulm politik, në këtë kohë fushate, gjoja se në Bresanë nuk është bërë punë, por jemi shumë të mirë në letra. E keni shumë gabim. Mund të jemi të mirë në paraqitjen e punëve tona, por nuk mungon assesi puna dhe këmbëngulja e jonë si qeverisje, në mbarëvajtjen dhe në punët e mira në të gjitha fshatrat. Demolimet në Bresanë janë bërë, por edhe zbulimet kanë ardhur gjithsesi. Duhet pasur sy pak me i pa ndryshimet dhe përmirësimet në fshatin Bresanë, mirëpo varet nga këndvështrimi që i shikoni. Kjo është me rëndësi. Nëse i shikoni si kundërshtar politik, nuk ju duket asgjë dhe kjo është shumë e vërtetë. Ndërsa, nëse i shikoni si qytetarë, realisht, ajo punë që është bërë për katër vite, gjatë mandatit të kryetarit Bexhet Xheladini, ka shumë pak për t'u kundërshtuar, dhe ajo që e përmendet më herët nga kolegu ynë, se ka kërkuar nga unë dhe Samidini, që të marrim pjesë në ndonjë kërkesë për qytetarët tanë apo të Bresanës në veçanti, sa herë kemi kërkuar diçka të mirëfilltë dhe të arritshme, është arritur për katër vjet të udhëheqjes të kryetarit Bexhet Xheladini. Faleminderit shumë!

Nexhat Selaj: Unë nuk jam person i replikave dhe nuk kërkoj replikë nga kryetari, absolut hiç. Por, do të kërkoj diçka pak më tepër, mos më mbet borxh diçka me m'kthy te përgjigjet. Tha se te ujësjellësi në Dragash nuk jemi kompetentë ne, por është Hidroregjioni. Ne si qytetar të Dragashit, ku e kemi adresën e ankesave. Ne përpos kryetarit që e kemi, nuk mund të shkojmë në Hidroregjion ne të bëjmë kërkesa për ndryshimin dhe për rregullimin e pjesëve të mbetura të cilat janë të pakryera, pikërisht që bëhet fjalë për ujësjellësin e Dragashit nëpër qendër. Ne nuk shohim adresë në Prizren. Adresën e kemi në Kuvendin Komunal në Dragash. E para, e dyta, nuk isha i kënaqur fare me përgjigjet të cilat m'i ktheve për fshatin Zym, kryetar. Unë pyeta, 120 mijë euro për mandatin tuaj 4-vjeçar ne i kemi ndarë, nga periudha e vitit 2021-2025. Ato para u dashtë të shpenzohen. Ju keni paraparë në buxhetin tjetër, për këtë periudhë 2026-2028, edhe 70 mijë. Unë po kërkoj 120 mijë euro të cilat i keni ndarë. Ato u dashtë të përfundohen deri në këtë mandat. Shumë shkurt i shkove te stadioni i Pllavës. Ka qenë projekt dyvjeçar, unë e kuptoj atë. Por, ka qenë projekt dyvjeçar 2023-2024. Kaloj 2025-ta, tash thuesh është duke u punuar. Ai u dashtë me u përfundue tash, kryetar, se ato parat ne i kemi ndarë në vitin 2023-2024. Faleminderit!

Driton Ademi: Kryetar, nuk je përgjigj te pyetja, shpronësimi i pronave të AKP-së, Dragash dhe Bresanë. Nuk e di ku janë qeto prona, veç e keni përmend si shpronësim. Dragash-Bresanë, cilat prona janë, nuk e dimë. Edhe një pyetje te Bresana, edhe po i ndërlihem këtu Xhyllferies, tha te demolimi e qeto sendet. Xhyllferie, pse s'more mundimin me thënë në Bresanë e ke pa, pse s'po

marrish me thënë që është i projektit edhe i 2024-tës, kur e ke miratue buxhetin. Edhe në 2023-tën ta gjojmë. Nuk jam kurgjo kundër. Vetë kemi kërkuar demolim, vetë e kemi mbështet, po ku je t'u pa park të lojërave në Bresanë, po më vjen shumë çudi. Park të lojërave në Bresanë, veç nëse e ndërtoni tash te sheshi. Edhe shesh, edhe park të lojërave me një vend, unë s'kam pa. Veç në Bresanë munden me qenë. Lista është veç në Bresanë. 2025 për 2026, veç po të shkrun Bresanë, a shuma është e njëjtë. Nuk e ke kuptue, veç pak ta shpjegoj. Në vitin 2024, në miratim të buxhetit për 2025-tën, e ke të shkruar ndërtimi i këndit të lojërave, në qershor është qekjo, është e njëjta shumë, 23 mijë e 900 euro. Edhe këtu veç Bresanë po shkrun 23 mijë e 900. Me qëllim nuk ia kanë qit. Qaj projekt është prej 2023-tës, po vazhdon deri më 2026-tën. Demolim, kënd i lojërave, ose kulme. Kënd të lojërave unë hala nuk kam pa në Bresanë. Edhe te tjetra, e ke keqkuptue, unë të kam pyet paraprakisht ty, edhe Samidinin, edhe ju kam thënë, a keni deni send për Bresanë. Ju më keni thënë jo, nuk kemi. Ose ju nuk keni pas, ose keni shkue vetë te kryetari i keni bo qeto propozimet, atëherë nuk keni dashtë me komunikue bashkë. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Zonjë Kryesuese, unë dhe ju nuk kemi ruajtur dhinë bashkë që të silleni kështu me mua. Duhej t'ju përgjigjesha për këtë. Më falni, qytetarë të nderuar, por shihni sjelljen e këtij pushteti ekzekutiv. Zotëri Kryetar, ju këtu pak më parë thatë se buxheti është ndarë në mënyrë të barabartë. 100%. Sa është, zotëri Kryetar, 40% nga 3.715.990 euro? Nëse është 100% i ndarë në mënyrë të barabartë, ejani këtu, më thoni sa është shuma në 40% të 3.715.990 euro. Këtu në investimet kapitale, totali për komunitetet jo-shumicë është 816.699 euro. A është kjo 40% nga 3.715.990 euro? Hajde, më mësoni. Matematika që kam mësuar unë në shkollë kështu thotë. Tregoni ju ndonjë matematikë tjetër ku mundet që nga 3.715.990 euro, 816.699 euro të jenë 40%. Sipas matematikës sime kjo nuk shkon. Ndoshta ju keni ndonjë matematikë tjetër. Ose matematikën e mediokërve dhe tradhtarëve që ju ndihmojnë në këtë. Unë nuk do t'ju lejoj. Deri në sekondën e fundit do të them të vërtetën dhe gjithmonë do të luftoj për të vërtetën dhe nuk do t'ju lejoj të na mashtroni. Bazuar në dokumentet tuaja, në atë që keni selektuar në propozim-buxhetin që ma keni dërguar me email. Unë nuk po flas nga mendja, as nuk e kam parë këtë në ëndërr. Unë e kam marrë propozim-buxhetin, kam ulur, kam llogaritur gjithçka qartë. Sipas investimeve kapitale që ju keni selektuar, plus që në atë seleksion keni futur Plavljën dhe Kaprën me 8 dhe 7 mijë euro, më del kështu: hajde ju më thoni sa është 40% nga 3.715.990 euro. Dhe ju, znjë Kryesuese, mos ma kufizoni lirinë e lëvizjes. Faleminderit.

Munir Jonuzi: Nuk më keni dhënë përgjigje në pyetjen se sa nga këto mjete për investime kapitale janë ndarë në Gorë dhe sa në Opojë. Numrin e saktë, jo përqindjen 60-40. Nëse flasim për përqindje, përqindjet e mia dhe të tuajat nuk përputhen. Mua më intereson numri i saktë. Nëse nuk i dini numrat e saktë, ja unë i kam llogaritur dhe mund t'ju jap numrat e saktë. Por, për hir të transparencës, për hir të qytetarëve tanë, na tregoni ju se cilat janë shifrat e parashikuara për Gorë, cilat për Opojë. Doni t'ju tregoj unë se cilat janë të gjitha shifrat? Nuk më keni dhënë përgjigje në pyetje. Për bashkëfinancimin e projekteve me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, 177.000 janë ndarë për linjat e tensionit drejt Restelicës. 53.500 euro ku shkojnë ato para? 53.500. A janë për Gorë, apo për Opojë? Nëse shkojnë për Opojë, atëherë përqindja është edhe më e vogël. Këtë do t'jua dëshmoj, kryetar. Të gjitha i bëj me tabela dhe argumente. Merrni excel-in. Nuk më keni dhënë përgjigje. Ndërtimi i rrugës drejt Kukuljanit. Ka qenë e parashikuar 100.000. Tani është 15.000. Është e mundur, kryetar. Pastaj, sa i përket punës me KFOR-in turk dhe LMT-në e tyre, LMT është ai që punon, zoti kryetar. Ju si kryetar nuk do të duhej ta lejonit këtë. Keni diku rreth dhjetë projekte, e katër projekte prioritare janë në Opojë. Katër projekte prioritare janë në Opojë. Që të gjitha këto të përfundojnë deri më 12 tetor. Nuk e di vetëm si nuk ju tërheqin vërejtjen partnerët tuaj të koalicionit, more njeri, që të bëni diçka edhe në Gorë, jo vetëm në Opojë. Pres përgjigje konkrete.

Uran Halimi: Kryetari tha që projekti i amfiteatrit është në përfundim. Duhet ta përcjelli unë atë, kryetar, se kur të pata thënë për një gropë atje te varrezat e Brrutit, thajë po e rregullojmë, prej gropës e bëtë kodër edhe nuk e rregulluat kurrë. E bëtë rrugën gropa-kodra. Mandej, e pranove atë propozimin tim te Ura e Haxhisë, nuk më dhaje asnjë përgjigje tash. Vitin e kaluar e pranove, masnej më thajë ka me u hap tenderi këtë muajin, nuk u hap as tender, as nuk u mbyll ai tender, as nuk është bo asnjë punim. Jetmiri foli për ato pushimoret e rrënuara në Gjerman të Zgatarit, shumë të shëmtuara. Të paktën shkoni hiqni krejt. Nuk thajë kurgjo edhe për atë. Jan do pushimore, do të drunit aty që pushojshin njerëzit. Edhe, gjithë ajo bukuri me shkue qytetari me u gërdit aty, nuk është në rregull. Se, përveç bërllogit, edhe pushimoret janë bo ma shumë se bërllog aty. Tjetra, më thajë që toruari, sipas kryetarit, nuk po iu dukta trotuari fshatit Kapre se, meqenëse nxënësit po i barten. Qytetarët ku duhet me ec? Unë nuk e di që bëhet trotuar veç për nxënës, po prej kalimtarëve aty ka edhe nxënës. Mos pastë nxënës të shkollës fillore, munden me pas të mesmes, edhe të fakultetit studentë munden me pas, kryetar, qytetarë të thjeshtë. Është mirë që, kur ta bëj një propozim, unë nuk jam t'u bo hajgare me atë propozim, po të paktën për hatër të qytetarëve. Edhe

te ajo pjesa Xhyllferia që tha me bo kërkesa gjithëpërfshirëse, zonja kryesuese mu ma ndaloi, se kam pas shumë kërkesa tjera me bo. Por ma ndaloi fjalën edhe tha boll bëre kërkesa. Sidoqoftë, unë pres mirëkuptim tuaj. Edhe, kryetar, po due me u realizue ato që po i pranon, ose ato për të cilat po votojmë. Dy herë është duke u vjedhë ujësjellësi.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Uran, unë nuk ta kam ndalë fjalën, ti e ke pas 10 minuta, në fillim, për një pikë të rendit të ditës. Këtë e dish ti më së miri, se ke qenë ulur. Por, ti para opinionit po thuesh ma ka ndalë fjalën. Ti ke qenë këtu ku jam unë. 10 minuta i ke të drejtë. Herën e dytë nuk ke pas të drejtë me dalë, ta kam dhënë, e prapë po thuesh nuk ke dhënë fjalën. Kjo është e rëndë. Jeni mësue qeshtu, po nuk ju ec këtu.

Artan Loshaj: Zotni kryetar, keni ndarë 50 mijë euro për ndërtimin e kulmeve të banesave. Edhe, thaje që janë të mjaftueshme, edhe për dy vite tjera 2027-2028, të gjitha këto për tri vite 130 mijë euro. Nuk janë 5 banesa, kryetar, janë 11, se unë jetoj në Dragash edhe munda me t'i numëruer. Ndërtesa, janë 11. Unë jetoj në Dragash qe 30 vite. Edhe banorët t'i numëroj një për një, kush banon në këto banesa. 30 vite jetoj në Dragash unë, ju të tjerët vini deri në ora 15:00. 11 janë, kryetar, a t'i numëroj. Le të m'i jep pesë minuta replikë, unë t'i numëroj banorët secili kush jeton aty. Sikur ti qysh e dish lagjen tënde, unë jetoj në Dragash. Edhe me 130 mijë euro, tri mundesh me i ndreq, ose qeto pesë tuat. Unë po të them 11. Minimum, merre një inxhinier, thirre, minimum 70 euro është metri katror. 11 banesa ka 200 metër katrorë minimum i kanë secila. Ato janë të moçme, të viteve 60-ta. Edhe për në fshatin Rrenc, nuk mora përgjigje, qe dy vite. Murin mbrojtës, të cilin doni me e bo me buxhetin e vitit 2026, me paret e fshatit Rrenc, të cilin gjatë punimeve firma fituese e tenderit që e ka marrë, i ka prish varrezat. Ke premtue këtu, dy vite, do ta ndreqim në pranverë. Katë vit, para fushatës po duesh me ndreq. Po të lutem, nuk është mirë me qato pare me e ndreq, kryetar. Me qato 60 mijë eurot e fshatit Rrenc nuk është mirë me e ndreq. Ma jep një përgjigje. Edhe, për fshatin Rrenc ke ndarë shumë pak pare, kryetar, për 2027-2028, veç 40 mijë euro. Domethënë, ty Rrenci të duhet veç për vota, sivjet si ta merr denjo, mirë, po 2027-2028 nuk të vyn mo Rrenci, se s'ka shumë vota për ty, 17 copa.

Shpetim Hajredini: Atëherë, nuk do e zgjas shumë, po kryetar e dha njëfarë përgjigje që preki edhe në pyetjen time, që ishte me ndriçimin publik. Tash, kryetar, nuk po e dimë na pas të 12-tit nëse je ti apo jo. Me propozimet që i kemi bo, do të dalin në votim, apo propozimi im është që po hyn në atë përgjigjen e kryetarit, që tha do t'i përfshijmë ndriçimet publike. Edhe subvencionet, por edhe ndriçimet publike i pata. Nga Granti i Performancës thaje do të jenë ndriçimet publike.

Ato fshatra, thaje, të cilat nuk e kanë ndriçimin publik të kompletuar, do të përfshihen nga Granti i Performancës. Unë e pata kërkesën time, pikërisht për ato pjesët e fshatit Kuk të cilat nuk e kanë ndriçimin. E jep premtimin që do të jetë edhe fshati Kuk në këtë shumë, nëse je ti, se nëse nuk je ti e jam unë, atë e përfshij vetë unë, s'ka nevojë dikush tjetër me ma krye. Po nëse nuk jam unë, e marrish premtimin që do ta kryjsh. Tjetra, deshta ta jap një propozim, besoj që është i arsyeshëm, se po që se votohet tash buxheti, s'po them asnjë, po bën vaki 60% e asambleistëve këtu nuk kthehen më për eventuale. Kish qenë më mirë që ta lëmë, ta votojmë pas pauzës, që t'i kemi këtu të gjithë. A, nëse e votojmë tash, qetu 60% e asambleistëve kanë me ik dhe nuk kthehen më.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Një herë ka me u votue buxheti, se mu dy asambleistë më kanë kërkuar leje, edhe nuk i kemi ne në votime ata. Kështu që, më duhet me e votue buxhetin. Kush kthehet, kush i ka votat, kush do me e përfaqësue popullin, kthehet. Kush nuk do, ajo është e drejtë e tyre. Por, mu dy asambleistë më kanë kërkuar leje pak, bile edhe është zgjat dhe ata i kanë disa obligime të veta.

Bexhet Xheladini: Po më vjen keq që po duhet me dalë dy herë, po megjithatë, unë nuk pritoj edhe dhjetë herë me dalë. Shpronësimi i pronave në Dragash-Bresanë, qekjo Asamble ka votue për të gjitha qeto pronat që janë në Dragash. Muj edhe me i përmend, por nuk kam nevojë. Ajo ish-ndërtesa e Sharrprodhimit, janë një parking këtu përballë xhamisë, pastaj është kjo ndërtesa e veterinarisë, edhe shkolla në Bresanë. Këto janë ato mjetet të cilat janë ndarë për shpronësimin e këtyre pronave. Jemi në proces të përgatitjes së dokumentacionit, edhe nëse do të kemi sukses, do ta bëjmë shpronësimin, do t'i marrim ato në pronësi të Komunës. Kur t'i marrim në pronësi të Komunës, atëherë kjo Asamble, kryetari i ardhshëm, do të bëjë një debat publik me qytetarë, do të vendoset çka do të bëhet me ato prona. Ne propozimin në AKP e kemi çue se çka duhet të bëjmë me ato prona, por mjetet që janë paraparë për këtë shpronësimin e këtyre pronave. Këndi i lojërave u përmend që disa edhe emri "demolimi i shkollës dhe ndërtimi i këndit të lojërave". Është kodi i projektit, edhe Ministria nuk e ndërron kodin derisa të përfundojë tërësisht projekti. Thashë, vitin e kaluar na i ka marrë përmbaruesi mjetet, nuk ka pas mjete. Këtë vit ka pas mjete, e kemi bërë demolimin e shkollës. Me mjetet 23 mijë euro, apo 25 mijë euro sa janë, do të bëhet vitin e ardhshëm këndi i lojërave për fëmijë, brenda oborrit të shkollës fillore. Sa i përket subfinancimit, janë të parapara përafërsisht 200 mijë euro, subfinancimi që do të përdoret për ndërtimin e lartpërcuesit në drejtim të Restelicës dhe në drejtim të Brodit, do të bëhet me mjetet e komunitetit joshumicë. Mjetet 40-50 mijë euro që janë tepricë, këto mjete do të shfrytëzohen për subfinancimin

e ndonjë projekti. Për shembull, varësisht ku vendos Asambleja me e bo, mund të vendoset edhe në Dragash, mund të vendoset edhe në pjesën e Gorës, mund të vendoset edhe në pjesën e Opojës. Edhe po ju garantoj, që ndarja e drejtë financiare është bërë cent për cent 40%, bile është dashtë 39 e diçka përqind, por është bërë 40%, por llogaritjen jeni duke e bërë gabim. Kështu që, pas seancës, kush të dojë në zyrë mund me ardhë, i kam aty shënimet. Por, ju duhet ta dini një gjë. Për investime kapitale janë të ndara 3,915,718 euro, për vitin e ardhshëm. Nga këto mjete, duhet të hiqen 406 mijë eurot, duhet të hiqet 200 mijë eurot, duhet të hiqen shpronësimet, duhet të hiqen investimet që bëhen në Dragash, duhet të hiqen investimet me bashkëfinancim. Edhe, kur të hiqen këto, atëherë mjetet që mbesin ndahen me proporcion, 40% me 60%. Edhe në këtë drejtim ne jemi shumë pastër, edhe për këtë garantoj me çka të duash. Nëse nuk është kështu, ata të cilët nuk po pajtohen me këtë, munden me m'qit në gjyq lirisht. Gjykata është e hapur, më çoni në gjyq, jam në gjendje me ju përgjigj. Por, është fushatë elektorale, edhe doni me përfitue diçka në këtë drejtim. Unë jam zyrtari më i lartë në Komunë të Dragashit, edhe jemi në proces të zgjedhjeve, nuk kam të drejtë që këtë foltore këtu ta keqpërdori për fushatë edhe për premtime të cilat nuk janë të parapara në buxhet. Por, ka pas edhe kërkesa këtu, që jashtë këtij buxhetit, ato premtime muj me i dhënë diku tjetër, edhe përgjigje dikuj tjetër muj me i dhënë. Kështu që, këtu, në këtë foltore, do të jap përgjigje vetëm në bazë të asaj çka ma lejon ligji edhe çka është e shkruar këtu në buxhet. Ju faleminderit edhe një herë! Mirë u pafshim!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, ishte veç diskutimi i fundit i kryetarit. Po vazhdojmë me propozimet që i dha kryetari. Mjetet nga fshati Krushevë të kalojnë te fshati Gllloboqicë, për ujësjellësin. Edhe tjetri, Pllajnik, ndërtimi i murit mbrojtës dhe kubëzimi në fshatin Pllajnik. Edhe subvencionet, 10 mijë prej kryetarit që të shkojnë në bujqësi, edhe 20 mijë prej DKRS me shkue në bujqësi. Atëherë, kush është pro këtyre propozimeve? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 5 kundër dhe zero abstenim, i kalojmë këto propozime të kryetarit. Propozimi i Shpetim Hajredinit ishte për ndriçimin publik, por kryetari e theksoi që këto do t'i bëjë përmes Grantit të Performancës. Nëse është kryetar, nëse nuk është, ti vetë thaje që e bëni ju. Nuk kemi nevojë me e qit në votim. Atëherë, e hedhim në votim Propozimvendimin për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026 dhe vlerësimin për vitet 2027-2028. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Uran – se më herët ishe jashtë – për të gjitha këto pika, të gjitha iu ka përgjigj kryetari, dhe të gjitha janë duke u kryer.

Bexhet Xheladini: Ndriçimi publik në pjesën e Opojës: Në të gjitha fshatrat ku nuk është ndriçimi publik, do të bëhet ndriçimi publik komplet. Në fshatrat të cilët është ndriçimi publik, por ka lagje ku nuk ka ndriçim publik, do të përfshihen në një projekt të përbashkët, me Grantin e Performancës, 24 mijë euro participim. Propozimi tjetër është që 10 mijë euro të hiqen nga subvencionet e Zyrës së Kryetarit, të shkojnë në bujqësi. Ky ishte propozimi i dytë. Propozim i tretë ishte që 20 mijë euro të hiqen nga kultura dhe të shkojnë në bujqësi, subvencione. Këto janë ato propozimet. Unë e kam fjalën për buxhetin. Edhe ishte një propozim, 9 mijë e 728 euro të hiqen nga fshati Krushevë – janë të hyra vetanake – dhe të qiten në fshatin Gllloboqicë për ndërtimin e ujësjellësit. Këto janë ato propozime me mjete financiare. Kurse, për pyetjet që i keni bo ju, të gjithëve ju kam dhënë përgjigje. Për propozimet që po i jepni ju, duhet me m'tregue ku me i marrë paret, se duhet me ia heq dikujt për me t'i dhënë ty. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Po vazhdojmë! Për propozimet e Uranit, shkojmë në votim! Kush është pro propozimeve të Uranit? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 12 kundër, atëherë me votën time do të jem kundër. Jo që jam kundër teje, por të gjitha kryetati i ka thënë.

Bexhet Xheladini: Të gjitha qato ti që i ke thënë, janë në proces, por ti i ke dëgjue që po bëhen ato, për një grusht vota dësh me bo këtu teatër. Kështu që, të gjitha ato që i ke propozue, janë të gjitha në buxhetin e vitit të ardhshëm. Nuk ke nevojë me dhënë përgjigje. Unë kisha kërkuar nga kryesuesja le të hedhë në votim Propozimbuxhetin. Fushatë bëjmë pas përfundimit të seancës.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, shkojmë me votimin e buxhetit, me dy propozimet e kryetarit. Kush është pro pikës së pestë? A ka kundër? Abstenim? Me 18 vota pro, 4 kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë Buxhetin e Komunës së Dragashit.

Pas pauzës, po fillojmë me pjesën e dytë të seancës. Jemi në pikën e fundit, pikën eventuale. Fjala është për ju. Kush do me e marrë fjalën?

Uran Halimi: Faleminderit! Deshta me e bo një pyetje. Në fakt, atë përgjigjen që parëz më mbet borxh. Kryetari tha, për propozimet që unë i kam bo, po tha ku me i marrë paret. Kryetar, te ai projekti i vjetshëm, i asaj pjesës së rrugës, te Ura e Haxhisë, i kemi pas të ndara 14 mijë euro. E dini shumë mirë, është propozue nga unë, është votue me shumicë të votave. Ti duhesh me ma dhënë një përgjigje, ku kanë shkue qato 14 mijë eurot. E unë po të përgjigjem që, me qato 14 mijë eurot mundesh me e bo atë projektin. Mandej, e bona propozimin për ujësjellësin e fshatit Shajne. Në planifikim buxhetor nuk është ujësjellësi i fshatit Shajne, kryetari tha do të bëhet. Kam qef me e ditë, qysh ka me u bo edhe kah kanë me ardhë paret. Mandej, e kam edhe një ankesë, një

denoncim. Është bërë këndi i lojërave te ajo pjesa te rruga “Shkëndija” në mahallën “Prifte”. Kryetar, ndriçimi që është bo, i atij stadionit ose këndit të lojërave, është i kyçur në rrjetin elektrik në mënyrë ilegale. S’ka aty numërues elektrik, thjesht, po vidhet struja. Nuk e di kush e paguan atë. Me siguri e paguajnë qytetarët. Po, është shumë e vërtetë. Mandej, te ato projektet që unë i propozova, nuk m’i përfilli, edhe zonja kryesuese votoi kundër atyre propozimeve të mia. Zonja kryesuese, ju votuat kundër një rrugës aty, ku kalon një nxënës, shkon në shkollë çdo ditë, te Ura e Haxhisë. Votuat kundër ujësjellësit të fshatit Shajne që unë e propozova me hy në planifikim buxhetor. Votuat kundër shumë... votove edhe kundër Bellobradit që tha kryetari po bëhet amfiteatri. Qe nja dy-tri mandate është duke u bo ai amfiteatri. Tjetra, u diskutua shumë edhe folëm gjerë e gjatë për këtë buxhetin e vitit 2025-2026. Morët edhe kritika, edhe akuza nga kolegët e mi të opozitës. Është për çudi, kur vjen puna te votimi, një pjesë – se nuk e di sa – votojnë pro këtij buxheti. Kështu që, herën tjetër mos e akuzo e kritiko një buxhet që e votojsh. Faleminderit shunë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Unë nuk votova kundër amfiteatrit, sepe amfiteatri veç është në përfundim e sipër. Edhe kreyta qato që i ke bo, qato kërkesat, ato janë duke u rregullue dhe duke u krye. Propozimet që i keni bërë, unë i dëgjova me vëmendje. Ne si Grup Parlamentar, si pozitë, i dimë punët e ekzekutivit. Për atë arsye, edhe nuk e kam mbështet.

Nedžmidin Sejdidar: Faleminderit. Kolegu Junuzi, do t’ju lutesha, nëse mundeni, të filloni të ma matni kohën, sepse koha me të cilën shërbehet znj. Kryesuese është si taksimetri i taksive të zeza, fillon nga dy minuta e lart. Zonjë Kryesuese, po flas pikërisht për mbledhjen e fundit kur e ndërpretët me forcë në asistencë të kryetarit në largim. Unë nuk kam folur më shumë se dhjetë minuta, kam folur tetë minuta, znj. Kryesuese, ju më keni vjedhur dy minuta kohe. Po flas për mbledhjen e kaluar që e ndërpretët kur z. kryetar tha ose do t’ia merrni fjalën, ose unë do të dal jashtë. Nuk e kam tejkualuar kohën prej dhjetë minutash, e kam parë videon disa herë, kam folur tetë minuta, ju më keni vjedhur dy minuta kohe, prandaj duhet të paktën të kërkonti falje mua dhe qytetarëve që më kanë dërguar këtu. Kolegu nga AAK-ja, është e pasjellshme të qeshni kur dikush flet. Unë gjithmonë ju dëgjoj me kujdes dhe ju jeni më simpatiku për mua këtu. Ndoshta ngaqë është mbledhja e fundit, prandaj ju ka ardhur e qeshura, por vërtet është totalisht e pakulturuar të qeshni me atë buzëqeshje cinike kur unë flas këtu. Çështja tjetër, z. kryetar, ndërsa po diskutonim për buxhetin, u ngritët, erdhët në këtë foltore dhe më sulmuat se unë po përpiqem të përçaj komunitetet në Komunën e Dragashit. Gjë që natyrisht nuk është e vërtetë, ju na keni sjellë një buxhet diskriminues, ju kam folur me argumente për këtë dhe akoma matematika juaj nuk ka

mundur të llogarisë përqindjet e atij buxheti. Mirëpo, z. kryetar, së bashku me partnerët tuaj të koalicionit, ju keni nisur projektin e asimilimit, meqë jemi tek komunitetet. Ajo që keni bërë ju në historinë e politikës në këtë komunë është nisja e një projekti asimilimi të komuniteteve joshumicë. Dhe kush do t'ju ndihmojë në këtë? Sigurisht satelitët tanë nga Gora me të cilët ju publikisht keni nënshkruar marrëveshje dhe kjo është një marrëveshje e shëmtuar që synon të shkatërrojë plotësisht Gorën. Qytetarët e mi në Gorë dhe banorët e Gorës janë të vetëdijshëm që ju, nga të gjithë kryetarët deri tani, jeni më i keqi i mundshëm për popullin e Gorës. Ju mund të nënshkruani qindra koalicione të detyruara me këdo, por rezultati i zgjedhjeve të 12-ës dihet në Gorë. Ju ka mbetur edhe pak si kryetar dhe do të ishte korrekte dhe e denjë të mos e kishit nisur një implementim të tillë dhe një shembull të keq që do të keqpërdoret në të ardhmen. Ju ja keni dalë në këtë, i keni gjetur mediokritetët tuaj që këto katër vite ju kanë dëgjuar si kukulla në teatër pa kundërshtuar, i kanë ngritur duart ashtu siç ka dashur, nuk kanë pasur guximin të shtrijnë këtu asnjë çështje thelbësore, pse? Sepse ju nuk ua keni lejuar. Në këmbim u keni dhënë thërrime torte përmes organizatave të ndryshme joqeveritare që janë themeluar dhe pranuar nga vetë delegatët këtu në këtë foltore, u keni mbyllur sytë ndaj veprimeve të ndryshme që kanë bërë, u keni dhënë pushtetin maksimal dhe u keni lejuar që duke përdorur infrastrukturën komunale, institucionet komunale, të ushtrojnë presion mbi qytetarët e kësaj komune. Thjesht keni bërë një grup njerëzish që mund të dalin në publik, të kërcënojnë, të bëjnë çfarë të duan dhe askush të mos mund t'u bëjë asgjë, të mos sanksionohen nga ligji. Fakti është se nga 45 mbledhje të Komitetit për Komunitete, ku ju keni pasur detyrim të merrnit pjesë, keni marrë pjesë vetëm në dy derisa nuk e keni vendosur nënkryetarin e komunës. Pas asaj, nuk keni marrë pjesë në asnjë Komitet për Komunitete. Komiteti për Komunitete është uzurpuar nga ju dhe ka punuar ekskluzivisht sipas direktivave tuaja dhe ka qenë totalisht jofunksional. Gjatë këtyre katër viteve në Komitetin për Komunitete, para tre viteve kemi marrë një kërkesë nga banorët e fshatit Mlike, që deri sot qëndron në ndonjë sirtar. Ju justifikoheni se numri i protokollit është i gabuar, që në vend se të shkonte në Komitetin për Komunitete ka shkuar në Zyrën për Komunitete. Mirëpo, ju të gjithë jeni në të njëjtën ndërtesë, përdorni një software shumë të sofistikuar për kërkesat. Nëse ajo kërkesë ka shkuar në vend të Komitetit për Komunitete në Zyrën për Komunitete, Zyra për Komunitete duhej ta kthente atë kërkesë prapa që të adresohet drejtpërdrejt në Komitetin për Komunitete. Ajo kërkesë ende sot nuk ka ardhur. Para pak ditësh patëm Komitetin e fundit për Komunitete në këtë përbërje të Kuvendit, atë kërkesë nuk e morëm. Në Komitetin e fundit për Komunitete morëm një kërkesë nga një

biznesmen këtu, për të cilën unë thashë se nuk është shkruar në gjuhë të kuptueshme për mua. Kishte shumë gabime gramatikore, megjithatë në votim ju vendosët që t’i propozohet Kuvendit dhe të futej në rend dite. Z. Miralem Rahte si kryetar i Komitetit për Komunitete sot kishte detyrim që kur miratohej rendi i ditës të dilte në këtë foltore e ta propozonte Kuvendit. Miralem Rahte nuk e bëri këtë dhe kjo tregon edhe një herë se ju po përpiqeni edhe me “pasin e dyfishtë” të shkatërroni një kërkesë në këtë Kuvend. Mirëpo ajo që keni bërë tani mund të ketë pasoja të mëdha për ju gjithashtu. Mund t’ju padisin penalisht pse nuk e keni sjellë kërkesën në Kuvend, pse nuk e keni propozuar Kuvendit, sepse ata tani e kanë lënë gjithë përgjegjësinë mbi ju. Edhe pse ju më keni paditur mua, unë nuk dua t’ju shoh në bankën e të akuzuarve. Ndryshe nga ju unë kam bindje tjetër dhe nuk dua të gjykojem me askënd. Në gjykata unë paraqitem vetëm kur mbrohem. E juve si një njeri i ri që sot e keni përfunduar mandatin në këtë Kuvend ju këshilloj të përpiqeni ta ndreqni atë gabim sepse ia keni bërë padrejtësinë vetes. Ju e keni mbështetur atë kërkesë që të vinte në Kuvend, ju nuk e keni propozuar Kuvendit për miratim në rend dite. Pse e keni bërë këtë le të mbetet për nderin tuaj. Zonjë Kryesuese ju do të mbeten tek ne e kujtuar si një kryesuese që është përpjekur maksimalisht të ndalojë lirinë e fjalës. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, saktësisht neni 39, u lejon delegatëve të Kuvendit të marrin pjesë në punën e komiteteve dhe komisioneve tjera, u lejon të flasin, por nuk kanë të drejtë të marrin vendime, pra të votojnë në komisionet apo komitetet ku nuk janë anëtarë të rregullt. Ju gjithashtu më keni mohuar të drejtën në Komitetin për Politika dhe Financa kur kam dashur t’ju tërheq vërejtjen për disa çështje. Edhe kjo, znj. Kryesuese, flet për ju, jo për mua, dhe është me rëndësi që publiku dhe qytetarët, sidomos qytetarët e Gorës sime të dashur, të kuptojnë se për çfarë administrate bëhet fjalë. Rezultati i zgjedhjeve më 12 fare nuk është i rëndësishëm. E rëndësishme është që i keni duruar të gjitha presionet, që nuk keni mundur të më thyni me oferta e presione të ndryshme, që të më bëni mediokritet siç keni të tjerë. Pak më parë znj. Kryesuese tentuat të ma impononi lirinë e lëvizjes. A mund të lëviz unë në këtë Kuvend apo nuk mundem, apo do të rri urtë në atë bankë atje si një fëmijë në klasë të parë të shkollës fillore. Këtë nga unë mos e prisni. Unë nuk jam mediokriteti që jeni mësuar t’ju dëgjojë, unë jam këtu të them atë që mendon populli im dhe këtë do ta them gjithmonë. Dhe për fund, zonja dhe zotërinj, çfarëdo që të ndodhë këtu, mund edhe të mos e përfundoj deri në zgjedhjet e ardhshme, por do të mbeten e do të jetojnë të gjitha fjalët që janë thënë përmes këtij mikrofoni, nga kjo foltore, sa të ekzistojë njerëzimi. Jeta ime nuk është aspak e rëndësishme, unë për këto katër vite, falë Zotit,

me punën dhe përkushtimin tim këtu jam bërë i pavdekshëm dhe për gjeneratat e ardhshme. Faleminderit.

Samidin Xheladini: Pjesë e këtyre diskutimeve jam edhe unë. Po çuditem – sikur mos me pas qenë prezent unë, edhe unë kisha dyshuar se parafolësi ka të drejtë. Edhe, fol si ciceroni. Di me folë shumë, por fol gjithnjë të pavërteta. Këtu e kemi prezent edhe personin i cili ka bo kërkesë. Personi në fjalë ka votue kundër, në Komitet për Komunitete. Edhe e ka kundërshtue kërkesën e juaj, zotëri. Miralemi edhe unë e kemi votuar për me ardhë këtu. Kuvendi ka vendos me ardhë me rendin e ditës të cilin e ka propozue kryetari me kryesuesen, dhe asnjë propozim nuk ka pas. Pse nuk u çue zotëria në fjalë, kur është aq xhentelman, me dhënë propozim, por ka shti përçamje? Nuk bën kështu, se opinionin nuk e di të vërtetën. Kërkesën na e kemi miratue, unë e Miralemi, me dy vota. Ky ka votue, të tjerët kanë abstenuë, edhe e kemi pru në Kuvend. Kuvendi është organi më i lartë i Komunes. E dyta, unë e kam parë në vazhdimësi që shti përçarje – nuk guxon me e marrë fjalën, se nuk ta kam përmend emrin, po e dish që për ty është fjala. Në vazhdimësi, prej fillimit të mandatit e deri në përfundim, ke shti përçarje, urrejtje, po kërkush nuk të ka ngue. Opinioni e di që ti e ke pas me tendencë. E kemi pas na zëvendës drejtorin e QKMF-së – ke bo poterë kinse me e miratue, ke dashtë me u shit patriot. Kur ka ardhë puna, e ke kundërshtue zgjedhjen e personit zëvendës drejtor. Absurditet më të madh mo nuk ka. Masnej, për krejt kërkesat ti që i ke bo, kur i ka miratue Kuvendi, masnej, masi i kemi miratue ne edhe kryetari, ti i ke kundërshtue masnej. Për me dalë në opinion, që qe unë jam kështu, e ata janë kështu. Nuk bën me dyfytirësi. Munafiki është më i keqi te Zoti, në Xhenem shkon. Dije mirë! Munafikë mos u bëni! E mbajsh qëndrimin, keq a mirë, veç mos u bën dyfytirësh. Asnjë nuk bën me u bo dyfytirësh këtu. Unë jam dëshmitar i gjallë i ngjarjeve. Edhe për ujësjellësit. Ujësjellësin e 15 fshatrave e kemi pru në Kuvend, zotnia e ka krye me plot përgjegjësi, ujësjellësin nuk e keni votue ju. Katër vjet ke lyp ujësjellës, ujësjellës, e ke votue kundër. Mos lyp mo ujësjellës, se ke votue kundër. Mos, se Zoti të vret!

Nexhat Selaj: Pasi që edhe i takoj fushës së arsimit, do të ndalem më së shumt që ta flas pak për fushën e arsimit. E, në fushat tjera, ndoshta veç një pyetje do ta kem për drejtorin e Financave. Për këto katër vite sa kam qenë si asambleist, kryetar, kam shpreh gatishmërinë për bashkëpunim, por nuk e ke pas guximin që të ftosh edhe të konsultohesh. Në fillim, kur ke ardhë si kryetar, ke thënë që do të jam kryetar i të gjithëve. Asnjëherë nuk ke bo ftesë që të bashkëpunojmë, pavarësisht se unë kam qenë i gatshëm. Se kjo qeverisje ka dështue dukshëm në fushën e arsimit, kam një mori

dëshmi dhe fakte. Uroj që qeverisjet tjera të mos kenë këso drejtori të Arsimit, pasi që ne i kemi fëmijët këtu, dhe po na kthejnë pothuajse të gjithë në aspektin e fushës së arsimit. Në radhë të parë, e din kryetar se në mënyrë të paligjshme keni bërë shkarkimin e thuajse gati të gjithë drejtorëve nga shkollat. Në vitin 2021, kryetar, kur e keni marrë mandatin, nëse i keni të dhënat, unë i kam nxjerrë të gjitha shënimet, i ke zyrtare, keni pasur 62 mësimdhënës pa norma të plotësuar. Kur e ke marrë qeverisjen në vitin 2021, keni pasur 61 mësimdhënës pa normë të plotësuar. Po e lini mandatin, me 96 mësimdhënës pa norma. Këtu e kam edhe drejtorin e Financave, i cili më vonë sigurisht se do të më jap sqarime, dihet mirë numri i nxënësve po vjen në rënie e sipër. Si është e mundur, kur numri i nxënësve zbritet, të rritet numri i mësimdhënësve. Dhe atë, për 35 mësimdhënës keni marrë më tepër, në krahasim me kërkesat të cilat janë. Unë e kuptoj fushatën, se ju për fushatë politike keni punësuar mësimdhënës. Por, ju nuk jeni mësues edhe nuk e dini se çfarë probleme qitni nëpër shkolla. Kolegët të cilët i takojnë kësaj fushës, këta shumë mirë e dinë se çfarë problematike sillet nëpër shkolla, sa bjer morali kur një mësimdhënës me normë të plotë 20 euro, paguhet 700 euro, dhe detyrohesh një mësimdhënës tjetër me 12 orë të marrë 700 euro. Këtu krijohet një anomali bukur e madhe te mësimdhënësit, bjer edhe niveli, bjer edhe puna e arsimtarëve. Keni 35 mësimdhënës më tepër, sesa që keni pranuar detyrën në vitin 2021. Nëse shikojmë dëmet komunale për këta 35 punëtorë që ke marrë më tepër, mund të llogarisim shumë lehtë. 30 punëtorë nga 700 euro, bëjnë 21 mijë euro më tepër në muaj, kryetar. 10 muaj janë 210 mijë euro. 4 vjet bëjnë rreth 800 mijë, rreth 900 mijë euro kemi bërë dëm vetëm buxhetit komunal. Me rreth 900 mijë euro që kemi dhënë ne më tepër, paramendoni sa kemi mund të investojmë nëpër shkolla. Kryetar, unë ta kam përgëzue një veprim që e ke marrë në vitin 2023, kur more një vendim që të gjithë nxënësve t'ua paguajmë udhëtimin. Për mu ka qenë një veprim shumë i mirë. Një veprim shumë i matur, që ta kursejmë paranë edhe xhepin e prindit. Rreth 120 mijë euro kemi ndarë për këta nxënës. Por, si nuk u tregove bujar, kryetar, që kemi 5 nxënës të cilët udhëtojnë jashtë regjionit, janë me nevoja të veçanta. Dy nga ata i ke të verbër, kryetar. Me kërkesën time të vitit 2023, i ke mbulue këta 5. Ata mezi presin, që në vitin 2024/25 nuk iu ke lëshue asnjë cent. Ne këtu pothuajse të gjithë jemi prind, edhe të gjinisë mashkullore, edhe të gjinisë femërore. Paramendo çfarë do të thotë, kryetar, që një nënë apo një babë, në kushte jo të mira, të detyrohet që një fëmijë të verbër ta ndalë nga shkollimi. Nëse nuk keni mundur që edhe 5 mijë euro t'i siguroni, që të paktën bare udhëtimin t'ua pagun këtyre nxënësve. Unë të isha lut, edhe si mësues, po edhe si prind, që në këtë rishikim të buxhetit që ju e bëtë pak më parë, unë prita mos po ka

ndonjë ndërhyrje, që ta gjeni një mundësi të paktën, më të vogël të mundshmen, që abre udhëtimi i këtyre 5 nxënësve – se janë 5 nxënës dhe nuk janë më shumë. Ne po paguajmë 120 mijë euro për nxënësit pa aftësi të kufizuara, me duar e me këmbë si themi ne shqip, e të mos i paguajmë këta fëmijë të cilët janë me nevoja të veçanta – pikërisht me fëmijë të verbër – është një dobësi, e para për ju si kryetar, e dyta edhe për ne si asambleistë, të cilët nuk kemi qenë gati që t’i rrimë këtyre fëmijëve në nevojë. Prurja e mësimdhënësve me vonesë nëpr shkolla, kryetar, pikërisht që bëhet fjalë për Shkollën e Mesme të Lartë “Ruzhdi Berisha”, shumë mirë e dini që vjet një gjysmëvjetor na kaloi pa mjekë edhe pa farmacistë. Unë kam kërkue nga ju që të ma bini ju një rregullore, si mund të notohet një nxënës kur nuk e ndjek një gjysmëvjetor të mësimi. Të jem shumë konkret, mësimdhënësit kanë ardhë, njëri më 2 e tjetri më 12 dhjetor. A është e mundur që ai një gjysmëvjetor të mos e ndjek, e drejtimi i mjekësisë dhe drejtimi i farmacisë, edhe në fund nxënësit të notohen. Kjo avari të cilën e keni shkaktuar në arsim, ka ngjallë edhe një të pazakontë që e kemi pas ne deri më tani. Është e vetmja gjeneratë, që kemi ne Mjekësinë në ShML “Ruzhdi Berisha”, të mos regjistrohet asnjë nxënës në mjekësi. Çdo vit na kanë konkurue në fakultetin e mjekësisë nga tre apo katër, kemi pas raste edhe pesë nxënës. Nuk ka pas vit që nuk është regjistruar të paktën një. Këtë vit – unë hedhi dyshimet se mosvijimi i rregullt i mësimi, pikërisht në Gjimnaz, na kanë pësue edhe nxënësit. Asnjë nxënës nuk na është regjistruar. Kur është për me e përmend ne Gjimnazin, thona kemi një akademi. Kur është për me ndihmue, heshtim. E filluat në vitin 2022, një rregullim të aneksit në ShML “Ruzhdi Berisha”. Aty, përpos që i keni vendosur katër shtylla të betonit, asgjë tjetër hiç. Katër shtylla, me qëllim të krijimit të hapësirave më të mëdha, edhe për dy klasë keni bo plan. Edhe ju, edhe ne. Jo që nuk u rregulluan ato, por ju u detyruat që këtë vit, brenda hapësirës, në pamundësi, t’i zëmë edhe koridoret, t’i shndërrojmë në kabinete. Kështu ngjan: e mbyllim një kabinet, e hapim një kabinet. Nxënësit e Ekonomisë – kolegë, nuk e dini, nuk keni qenë, ata të cilët dëshirojnë mund të vijnë të shohin – i kemi hequr nga klasa, i kemi vendosur në koridor, i kemi ndarë me dy pllaka prej gipsi edhe i kemi shndërrue në kabinete. Në vend se ne të investojmë – janë investimet, kanë qenë të parapara me investime që të ndërtohen edhe dy salla – ne i kemi bllokue ato dhe nxënësit i kemi qit në koridor. Çka është më e keqja, kur zihet hapësira publike, shtohet mundësia për ngacmimin e nxënësve mes vete. Dhe tash, paaftësia edhe pamundësia e lëvizjes së tyre të lirë, po na krijohet huti edhe po na krijohen probleme shumë të mëdha brenda në hapësirat e shkollës. Në vitin 2022/2023, në kalendarin e juaj të programit, keni pasur edhe kuize të diturisë. Ku mbeten ato kuize, kryetar? As në 2022-tën, as në 2023-tën, as në

2024-tën, kaloi 2025-ta, edhe 26-ta e 27-ta, e 28-ta, unë nuk kam pa kuiz. Ne si mësimdhënës e dimë se sa prioritet është kuizi i diturisë brenda shkollave. Kështu që, nëse jeni – sepse po e vë në pikëpyetje se do të jeni në qeverisjen e ardhshme, besoj se jo – atëherë do të ketë kush që të vë në funksion edhe kuziet e diturisë. Në kalendarin e shpenzimeve të vitit 2024, kryetar, shkruan – e marr shkollën time, pasi e kam edhe vendasin këtu – thotë: në shpenzimet 2660 euro brenda vitit janë pague në shkollën “Sezai Surroi” kujdestari, punë gjatë natës dhe orë shtesë të mësimdhënësve. Orë shtesë të mësimdhënësve, po muj me marrë me mend se ka pas ndonjë orë që dikush është pague më tepër. Po ne i kemi 66 punëtorë pa normë të plotësime. Si mundën këta me u pague, e para, edhe e dyta, kujdestari – Men, a kem kujdestari në shkollën “Sezai Surroi”? – unë nuk e di se kemi kujdestari, nuk e di që ruan dikush. Të gjitha shkollat i ke të tilla. Në “Ulina” – Qamilin e kemi këtu – kujdestari, punë gjatë natës, punë e orëve, 1421 euro. Këtu të kam, shoq, a ka roje natën shkolla? Të gjitha shkollat i kemi të tilla. Kemi minimumi vetëm në Opojë 7 apo 8 shkolla, në mos gabojë, edhe në territorin e Gorës i kemi po aq thujse, në secilën shkollë shkruan “roje”. Unë nuk e di – këtu jemi prezent të gjithë nga fshatrat – nëse ka kujdestari natën diku, përpos shkollës “Ruzhdi Berisha” që e di se paguhet roja natën, unë nuk e di nëpër shkolla a ka diku, pagesa këtu figuron. Edhe në fund, sa i përket buxhetit të cilin e kaluam, secili ka te drejtën e vet që ta miratojë apo jo, unë e kam parë të arsyeshme, pavarësisht se ka shumë mangësi, ka edhe të mira. Kështu që, e gëzofshna na si PDK ta udhëheqim këtë buxhet, bashkë me ju. Faleminderit! Në fund, ndoshta diku e kam teprue, ka mundësi ta kem lënduar ndonjë koleg, gjatë kësaj qeverisje katërvjeçare të LDK-së, unë si asambleist, ju kisha kërkuar falje, pa qëlli, ju kërkoj falje të gjithëve! Sigurisht se do të jem edhe në mandatin tjetër! Ju faleminderit shumë!

Driton Ademi: Atëherë, unë disa pyetje i kam bo edhe më herët, po nuk kam marrë përgjigje, po është mirë tash edhe me i ditë disa pyetje. Kryetar, a je në dijeni që nxemja – ta kam bo një pyetje në fillim të vitit për nexmjën në QMF në Bresanë, që tri vjet nuk punon, plus që ni vjet edhe agregati nuk punon në Bresanë. Nxemja që tri vjet edhe agregati që një vit. Kur nuk ka rrymë edhe nuk punon agregati, a ka vaksina aty? Unë po të pyes a ka vaksina, ku ruhen ato vaksina? Kur nuk ka rrymë, ku? Kryetar, në vitin 2023, me miratimin e buxhetit i kam pas dy kërkesa, një për reshetka te rruga “Dëshmorët 1912” të cilën vetë e ke miratue, ke thënë që do ta futim në buxhet, por kjo nuk ka ndodhë. Pse nuk ka ndodhë, nuk e di. Qe dy vjet, këto punë nuk janë krye. E përmendën këndin e lojërave në Bresanë edhe në shumë shkolla, po hala s’u krye salla e sporteve. Ajo ka mund me u krye, ju keni mund me ia pre shiritin, po pajisjet brenda, veç një rrjetë që është

edhe nja dy rrjeta të basketit, kurgjo nuk ka. Nja dy kosha. Te pjesa e shkollave, kryetar, sidomos shumica e shkollave, e përmendi profi Nexh që nuk kanë siguri. Edhe, në mos gabofsha, javën e kaluar ka pas edhe diçka përleshje këtu në Gjimnaz. Por, në shumicën e shkollave e ke pa kamera të sigurisë. Edhe e ke premtue këtë publikisht që do t'i ndreqim kamerat e sigurisë, po nuk i ke bo. Qe dy vjet unë i kam kërkue kamerat e sigurisë, nuk ke bo asnjë. Edhe te një kërkesë që e kemi bo, në mos gabofsha para një viti, për siguri në trafikë. Sidomos fsahtrat ku janë rreth magjistraleve, kemi kërkue me i vu shiritat e bardhë, sikur pjesën që është te Vlashnja, a diçka të ngjashme. Prej këtu nuk kemi marrë hala asnje përgjigje, ose asnjë punim nuk është bo.

Miralem Rahte: Përshëndetje të gjithëve, po paraqitem pasi u përmenda. Në Komitet saktësisht kemi marrë vendim që kërkesa e z. Fehim Sali të futet në rend të ditës së Kuvendit. Meqë nuk munda ta propozoj këtë mëngjes, unë, që të mos shqetësohet z. Nexhmidin, sipas detyrës zyrtare e kam dorëzuar kërkesën në sportel, e cila i është adresuar Kuvendit. Së dyti, z. Nexhmidin, gjithçka që keni thënë deri tani këtu, nuk ka asnjë peshë. Këto katër vite, dilni në foltore dhe tregoni çfarë keni bërë për komunitetin tuaj dhe në përgjithësi për komunën e Dragashit, si politikan, si njeri që qytetarët ju kanë dhënë besimin, përveç se jeni një marionetë që as vetë nuk e dini për kë punoni. Por tregoni, kam bërë këtë dhe këtë për filanin, nuk ka rëndësi për kë, këtë dhe këtë. A keni ndonjë vepër që keni realizuar këtu, përveç se flisni pa lidhje në këtë foltore për këto katër vite. Faleminderit.

Nedžmidin Sejdilar: Mua më duket me të vërtetë qesharake kur vjen dikush që mat meritat e mia, e ai vetë nuk ka dinjitet, as karakter e as shtyllë kurrizore. Për këto katër vite, z. Rahte, ju keni qenë leckë e kësaj pushteti. Keni bërë punët më të pista për ta, nga të cilat edhe ata vetë turpërohen. Ju nuk mund të matni peshën e diçkaje me vlerë, kur vetë nuk keni vlerë si njeri. Që njeriu të masë vlerën e tjetrit, duhet të ketë pak turp e ndjesi morali, e te ju turpi është i huaj. Ju, z. Rahte, nga ky pushtet keni marrë para përmes organizatës suaj joqeveritare. Po të kishit pak turp, nuk do ta kishit lejuar këtë. Si mund ta vlerësoni ju punën e dikujt? Ju thjesht nuk keni shtyllë kurrizore, ju jeni leckë e këtij pushteti. Ju jeni këtu një mediokritet i ngarkuar të absorbojë gjithë negativitetin e tyre që të mos dukej se pushteti ushtron presion. Të gjitha kanë kaluar përmes jush, këto janë “meritat” tuaja, z. Rahte. Për ne do të gjykojë historia një ditë. Do të shohim kush do të jetë në cilën anë. Unë, falë jush, jam bërë i pavdekshëm. Ndërsa trupat tanë do t'i hanë krimbat, gjarpërinjtë e të tjera. O njeri, që të vlerësosh punën e dikujt, duhet që ti vetë të kesh vlerë. Ju jeni njeri që nuk keni asnjë vlerë në vetvete. Keni dëgjuar, keni shtyrë, keni votuar. Ju jeni njeriu që sapo votuat për

buxhetin e tyre diskriminues. Dhe ju do t'i flisni dikujt për meritat? Pak më parë keni votuar për një buxhet diskriminues, ju e ngritët dorën tuaj, z. Rahte. Më tej, për sa i përket kërkesës së z. Fehim Sali, ju kishit detyrim të dilnit në foltore. Ju them përsëri, ju e keni mashtruar këtë njeri me “pas të dyfishtë”. Dhe asgjë më shumë. Dhe përsëri i keni shërbyer këtij pushteti si leckë për t'i larë. Faleminderit.

Miralem Rahte: Z. Nežmidin, unë nuk kam thënë që ju të më lavdëroni këtu. Ju përsëri thatë për meritat e mia, që falë meje jeni bërë ju i pavdekshëm. E falë jush, kush ka pasur dobi – nga populli, nga komuniteti, në përgjithësi në këtë komunë – a ka pasur dikush hajr, siç thuhet, për shkak të jush, përveç dëmit? Dëmin e kanë parë të gjithë. Të fala.

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit, znj. kryesuese, unë do të përpiqem të mos e përmend emrin e bashkëbiseduesit, që të mos polemizojmë mes nesh. E megjithatë, ai është aq i gatshëm e i aftë, ndonëse tashmë nuk ka më peshë, nuk e shoh askund në politikë, nuk mund të takohemi as në ndonjë duel televiziv apo radio. Thjesht, ai nuk ekziston. Megjithatë, zoti që pyeti këtu çfarë kam bërë unë e çfarë ka bërë ai... Falë meje, zonja dhe zotërinj, asnjë qytetar nuk ka pësuar dëm. Falë jush mediokritetëve, qytetarët e komunës së Dragashit, qytetarët e Gorës sonë të bukur, kanë pësuar dëme, sepse pak më parë ngritët dorën dhe miratuat një buxhet të shtrembër, diskriminues. Gjysmën e parave që duhej t'i takonin Gorës ia dhatë një ane tjetër. Këto janë meritat tuaja. Edhe unë, falë jush, jam bërë i pavdekshëm. Sepse këtu, po të mos kishte pasur mediokritetë si ju, nuk do të dihej kush është në anën e së vërtetës e kush është në anën e propagandës dhe gënjeshtreve.

Munir Jonuzi: Duke pasur parasysh se edhe unë nuk kam marrë disa përgjigje për pyetjet e mia, do të duhet t'i parashtroj përsëri. Së pari, nuk më është përgjigjur sa fonde nga ky buxhet janë ndarë për investime kapitale në Gora dhe sa në Opoje. Na është dhënë një përqindje 60-40 nga ana e kryetarit, e cila sipas meje nuk është e saktë. Pse nuk është e saktë? Gora në kuadër të investimeve kapitale merr 1.106.918 euro. Kjo është brenda investimeve kapitale. Më tej, në shëndetësi 40.000 euro, arsimit 42.000 euro, sporti 52.000 euro. Gjithsej bëhen 1.240.918 euro. Opoje: 1.682.629 euro në kuadër të investimeve kapitale. Për shëndetësi nuk ka asnjë euro, arsimit 43.900 euro, sporti 194.851 euro, gjithsej 1.921.380 euro. Për projektet e përbashkëta kemi 753.420 euro. Sipas llogaritjeve të mia, kjo jep një raport prej 61 ndaj 39. Bazuar në këto të dhëna, vlera totale e të gjitha këtyre investimeve kapitale është 3.915.718 euro, ashtu siç është shënuar në vendimin për buxhetin. Shpërndarja e buxhetit nuk bëhet vetëm në bazë të numrit të banorëve. Numri i banorëve në këtë komunë është 60% komuniteti shumicë, 40% komuniteti jo-shumicë. Cilët janë faktorët

tjerë që ndikojnë në shpërndarjen e buxhetit? Territori. Territori i Gorës është më i madh se territori i Opojës. Të gjithë e dimë këtë, shikoni planin zhvillimor, aty janë shifrat: rreth 400 km këtej, 400 km andej. Bazuar në këtë, Gora duhet të marrë edhe disa përqindje më shumë. Z. kryetar, ju jeni në pushtet me partitë nga komuniteti jo-shumicë? Pse nuk i keni respektuar ata? Pse nuk u dhatë të paktën 2% më shumë për mbështetjen që ofrojnë në Gorë? Në mënyrë që raporti të mos jetë 61 ndaj 39, por 58 ndaj 42? Z. kryetar, më keni thënë se për rrugën Kukaljanë–Dragaş keni biseduar me zv/ministrin dhe se pushteti qendror do të marrë përsipër rehabilitimin e rrugës. Mirë, nëse pushteti qendror e rehabiliton rrugën, pse ne shpenzojmë 25.000 euro shtesë? Apo bëhet fjalë për trotuaret në atë segment? Nëse bëhet fjalë për trotuarë, pse nuk e keni përcaktuar qartë që projekti është për ndërtimin e trotuarit në rrugën Dragaš–Kukaljanë? Të gjithë e dimë se ka dallim të madh midis trotuarit dhe rrugës: trotuari është për këmbësorë, rruga për automjete. Më tej, nuk më është përgjigjur pyetja për punësimet. Në buxhetin bazë kemi të drejtën për 764 të punësuar në këtë komunë. Sa është përqindja e komunitetit jo-shumicë? Në shëndetësi dhe në administratën komunale? E di që nuk jeni përgjegjës për shkollat, postën apo policinë, por jeni përgjegjës për administratën komunale dhe shëndetësinë. Kërkesa e fshatit Mlike, që kolegu pak e përmendi. Arsyeja për refuzim? Sepse numri ishte i gabuar. Kërkesa ishte dërguar Komitetit për komunitete, por mbërriti në Zyrën për komunitete. Kërkesa e fshatit Mlike ishte adresuar për Komitetin për komunitete. Kjo nuk është gabim i qytetarëve, por gabim i shërbëtorëve tuaj, nëse numri gabon. Më duket çuditshëm që Komiteti për komunitete dhe Zyra për komunitete kanë kodet e tyre të veçanta. Pse? Sepse Komitetin për komunitete e ka themeluar kjo Kuvend. Komiteti duhet të ketë numrin 1, po ashtu si Kuvendi. Nëse Zyra për komunitete ka numrin 7, duhet të kishte numrin 2, sepse është pjesë e Zyrës së Kryetarit. Këto kërkesa për biznesmenin Fehim Sali, nëse kanë mbërritur te Komiteti dhe Komiteti ka marrë vendim që ta dërgojë në Kuvend, atëherë është detyrë e kryetarit të Komitetit për komunitete që në këtë Kuvend, në këtë foltore, të ndajë qëndrimin e Komitetit me ne. Unë në mandatet e mëparshme kam qenë kryetar i Komitetit për komunitete. Mbase kam dalë dhjetëra herë në foltore për të paraqitur qëndrimin e Komitetit. Nëse kryetari nuk ka përfunduar këtë detyrë, kolegu Samedine dhe ju mund të keni ndihmuar, të dilni ju këtu dhe të thoni se Komiteti ka vendosur që të përfshihet ky propozim në rendin e ditës. Kryetari duhet të i drejtohet Kuvendit, jo shërbëtorëve. Keni përmendur edhe zv/drejtorin e QKMF-së? Diferenca midis emërimit të kryetarit dhe vendimit të Kuvendit është e madhe. Emërimi i kryetarit është momental. Sot ky kryetar ka dashur gjatë këtij mandati të emërojë drejtorin nga komuniteti jo-

shumicë, dhe e bëri. Nesër mund të vijë një kryetar tjetër që nuk do ta ketë këtë dëshirë. Nuk do të ketë kush ta detyrojë. Por nëse do të kishim në rregullore vendim të Kuvendit, ai do të ishte i detyruar të emërojë zëvendësit. Këtu qëndron dallimi midis emërimit dhe vendimit të Kuvendit. Këtu qëndron edhe dallimi për të cilin ne kemi luftuar. Sepse nesër do të vijë një kryetar dhe do të thotë: “Ju kam dhënë zëvendësin”. Jo, duhet të thuhet: na takon sipas vendimit të Kuvendit. Për këtë kemi luftuar. Dëshiroj të uroj të gjithë delegatët shumë sukses, shihemi në këtë foltore. Faleminderit.

Agron Gashi: Në këndvështrimin e kësaj Asambleje Komunale dhe në përfundimin e këtij mandati katërvjeçar, do t’ju kisha mbetur borxh kësaj Komune, këtyre qytetarëve, këtyre asambleistëve, të mos kyçem në këto rrjedha apo në fjalitë e fundit që i mbajti z.Sejdilar. Zotëri Sejdilar, më dëgjo, t’u kisha lutur me vëmendje, kjo Asamble Komunale i ka procesverbalet, fjalë për fjalë, pikë për pikë, presje për presje. Kjo Asamble Komunale ka Radio Sharrin që ka qenë në incizim të rregullt, edhe live. Kjo Asamble Komunale e ka Televizionin Opoja dhe, vetëm pak nëse merr e hulumton dhe e shikon, sheh shumëçka, se i vemti asambleist që t’u dhënë fjala më së shumti në këtë Asamble, në proporcion me të gjithë asambleistët e tjerë, jeni ju. Ju e keni pas të drejtën e fjalës, sa asnjë asambleist nuk e ka pasur. Por, çka keni përfaqësuar, sa keni ditur të përfaqësoni, ajo është një temë tjetër, se ke qenë i komanduar nga struktura tjera, nga parti tjera dhe çdo gjë që t’u transferue në telefonin tuaj, ke dalur para kësaj foltoreje dhe je munduar të pësjtellosh në këtë Asamble Komunale. Por, nuk ishe origjinali i politikës së komunitetit goran apo të pakicave tuaja. Ti ke qenë kryekëput njëpërcjellës i informacionit që ta kanë dhënë të tjerët. Edhe kolegu yt më parë tha se vetëm ke dalë sa për të bërë patërdi për të prishur këtë Kuvend, për të neglizhuar këtë Kuvend, se përndryshe politikat nuk kanë qenë frytdhënëse dhe profitabile. Mandej, nuk ke dalë të tregosh mirë të vërtetën e komunitetit goran që thuesh shkelje, shkelje. Nuk është e vërtetë, sepse i dimë fort mirë se si kanë vepruar ky komuniteti goran. Ke pasur zyra, ke pasur dokumente, ke pasur mësim paralel, i ke edhe sot e kësaj dite, por asnjëherë nuk dole me thënë se shteti i kësaj Kosove, me thënë hej, kjo po ndodh. Kështu që, je munduar të pësjtellosh sa herë ke dalë në këtë foltore. Por, ju keni gëzuar të drejtën në maksimum. Një kyçje tjetër që deshta, pak a shumë, të flas lidhur me profën Nexhat, që tha se kemi shkelje, kemi mosplotësim të kërkesave në drejtimin arsimor. Është e vërtetë, pajtohem me disa pikëpamje, por duhet të bësh dallimin, se ky kryetar nuk ishte nëpër gjykata. Ky kryetar nuk i pat drejtorët të dëbuar, të suspenduar nga ligjet dhe nga gjykatat për shkeljen e të drejtave të punëtorëve, gjë që ishin

prezente më herët, drejtoritë e mëhershme kishin të suspenduar, ishin të larguar, deri edhe të dënuar që me vite mos me u kthye në vend pune, edhe burgin me e bo. Po falë Zotit, jeni gjetur dhe kanë shpëtuar pa burg. Kështu që, ky legjislativ, këta drejtorë dhe ky kryetar nuk i ka pasur këto probleme që i kanë pasur qeverisjet paraprake. Mandej u fol edhe një fjalë tjetër, që harrova të sqaroj, se tha kryetari më i dobët që në kohën e pasluftës. Jo! Është një vlerësim nga auditorë të brendshëm, të jashtëm, dhe është nxjerrë me një performancë pune të suksesshme dhe me një investim kapital që i ka harxhuar të gjitha mjetet, ka arritur qeverisja Bexhet Xheladini mbi 2 milionë euro nga niveli qendror për performancë pune. Por, dallimi nga të tjerët qëndron se, për 14 vjet qeverisje komunal nga partitë tjera, 14 milionë janë kthyer në suficit, që nuk kanë qenë të denjë për t'i harxhuar, dhe se këto janë parametra që shihet dallimi, si toka me qiellin. Duhet me qenë transparent pak, jo për ta dezinformuar opinionin, se kështu e kështu ka ndodhur. E vërteta është se sukseset e z.Xheladini, edhe partitë e juaja dhe të tjerat, të gjithë e dëshmoni nën hije, po përpara jo, me dalë me i thënë, kryetar, e ke meritue bre, gjithçka është okej. Por, në anën tjetër e pranoni se është më i suksesshmi i mundshëm, por kur delni para kësaj foltores, thoni jo, është dështim, është i pasuksesshëm. E vërteta është se nuk kemi vlerësuar na, kanë vlerësuar auditorë të nivelit qendror që kanë ardhur këtu dhe kanë administruar çdo punë që është kryer dhe që është bërë në këtë Komunë. Dhe është vlerësuar me performancë pune, ka lajthitur, ka tërhequr 2 milionë euro investime për performancë pune. Dhe, uroj që edhe mandati katërvjeçar i ardhshëm të jetë një mandat i suksesshëm dhe me punë të suksesshme, siç po ju urojnë edhe ata fshatra që ishin me vite të tëra pa ujë, të etur, dhe ata sot të urojnë, çdo ditë ke urata sepse uji i është sjellur 15 fshatrave, një uje, i cili është e drejtë më elementare dhe esenciale për shoqërinë. Por, gjithashtu edhe kanalizimet që po sillen, dhe shumë punë të tjera që janë bo, në Gorë e Opojë, këta qytetarë duhet ta hapin syrin dhe, dita po vjen, 12 tetori. Të jenë syçelë, vigjilentë, të shohin se, a meritosh, po votën, nuk meritosh, dëbo. Por, jo për t'u bërë grupacione shoqërore për ta hëngër e për ta zaptuar një luan. S'kam fare, por po flas për të vërtetën. Kam mundur të kem, por ka qenë dëshira ime që të mos jem kësaj radhe. Kështu që, suksese të mëtejshme, kryetar. Kolegë, kërkoj ndjesë nëse dikush ndihet i thyer për këto katër vite që kemi qenë këtu, por mbi të gjitha u mundova tërë kohën që të flas mbi realitetin, mbi të vërtetën e kësaj komune. Faleminderit shumë!

Samidin Xheladini: Kështu: Dritoni ka dalë, po e dëgjon përmes mjeteve të informimit, i kallxoni edhe ju, se ia keni shkruar ju. Gabim ia keni shkruar. Në QMF-Bresanë punon agregati, punon nxemja. Unë kam inventar 24 orë, kam dy frigorifera që ruan edhe vaksinat aty 24 orë. Këtë ia

kanë dhënë dezinformatë. Duhet një herë me e vërtetue, nëse doni shkojmë komision e vërtetojmë. Ka mundësi të prishjes, një herë ka ndodhë agregati u prish, në mëngjes unë jam aty si mbikëqyrës, e kam njoftue, pasdite u rregullue. Ka vullnetarë, njeri e ka ndreq vullnetarisht. Këta zotëri që sabotojnë, që e kanë sabotue edhe ish-kryetarin edhe ish-drejtorin – po ju kallxoj, se po më vjen keq – ka thënë kryetari në debat që ditën e shtunë nuk punon ambulanta në Bresanë. Drejtori, që e ka emëruë kryetari juaj, e ka mbyllë ambulantën. Ky e ka hap kur ka qenë kryeshef edhe drejtor, ai e ka mbyllë. Edhe po del po folë! Po ti e ke mbyllë, o zotëri. Po më vjen keq, e ka mbyllë. E dyta, drejtori më ka thirrë mu vitin e kaluar – jam konë duke pi kafe ma qat zotëriun qatje – më ka thënë drejtori i QKMF-së, Endrit Piraj, hajde urgjent në Kujdestari në Dragash, i ka thirrë nja 30-40 punëtorë që e kanë marrë pushimin edhe nuk i janë përgjigj kërkesës. Unë kam ardhë vullnetarisht edhe e kam krye. U bo polemikë e madhe, pse ky me shkue. O zotëri, ti nuk e ke krye detyrën, janë ata kompetentë me shkue. Ata e kanë marrë pushim, normal që i takon me ligj, në kohën e verës, korrik, gusht, shtator, kur i ka konvenue, edhe ka mbet QKMF-ja pa kujdestari. Kam shkue vullnetarisht. Mos bëni aso gjëra, se duhet shërbimi ynë human, fisnik. Deshta ta sqaroj një gjë, që mos bëni me i hutue njerëzit, me përdor emra e njerëz.

Nedžmidin Sejdlar:

Nexhat Selaj: Thashë pak më parë, nuk jam i replikave, por po më nxit një koleg. Nuk e vë shumë me rëndësi, me rëndësi është kush e parashtron pyetjen dhe si e parashtron, pavarësisht, unë do t'i përgjigjem. Kolegu i cili foli pak më parë, nuk a ishte në qasje a jo, unë nuk e përmenda qeverisjen komunale, e përmenda Drejtorinë e Arsimit. Si Drejtori e Arsimit, më e dështuara deri më tani, nuk kemi pas. Faktet ishin të shumta. Unë do të ju drejtohem juve. Pa emër, nuk përmendi emër. Vijnsh nga fshati Brezne, shkolla “Shaban Shabani”, je në shkollë edhe je mësues. A të duket e rregullt që të paguhen 4221 euro roje edhe punë nate? Ka roje në atë shkollën nga vijsh ti edhe që ruan dikush, ka punë natën atje? Nëse ka, urdhëro del e fol. Më vjen mirë që kryetari ka edhe avokatë pa pagesë. Shumë mirë, mbroje! Të drejtën del e fole këtu, jo nga vendi atje, jo që të mbrosh interesat e dikujt. Urdhëro, mbroje të drejtën e mësuesit edhe të drejtën e nxënësit, se je mësues. E dyta që kam me t'u drejtue, po nga fshati yt e ke të verbër fëmijën, që prindi mezi arrin t'ia sigurojë biletën e autobusit. Nuk e ke turp që të dalësh të flasësh këtu? Thaje drejtorët e shkollave. Cili drejtor i shkollave në mes të mandatit është larguar? Ma thuaj ti një drejtor! Ne kemi qenë 12-14 vite në udhëheqje, të gjithë drejtorët pasi e kanë krye mandatin, nuk iu është vazhduar. Nuk iu është vazhduar edhe tash, është krejt normale, për mu shtë normale, nuk e ka

marrë, ka marrë të partisë së vet, krejt në rregull. Veç në mes të mandatit, me performancë nga Ministria, të largohet, a është në rregull kjo? Mësues je. Tjetra, t'i ndahet klasa mësuesit, a është në rregull kjo? Por, këto janë të gjitha fakte të cilat mund të dalësh këtu të flasësh.

Shpetim Hajredini: Jam i detyruar pak të kthehem dhe të replikoj me njërin nga asambleistët e pozitës i cili, kur diskutuam për buxhetin, ai u përqendrua më shumë për qeverisjen e kaluar duke e akuzuar. Unë do t'ia numëroj disa projekte madhore, shumë të rëndësishme, të cilat i ka kryer ai ekzekutiv. Ky koleg i nderuar e di që unë flas vetëm për këto tetë vite të mandatit tim dhe nuk kaloj para se me qenë unë pjesë e Asamblesë. Prandaj, i nderuar koleg, edhe diçka duhet t'ju sqaroj që, në katër vitet e fundit, kur ky Kuvend, kjo Komunë e ka pas në dorë ekzekutivin PDK-ja, dy deri në tri vite nga këto katra, ka qenë i përfshirë dhe ka qenë pjesë ku është ballafaquar edhe me virusin COVID 19 dhe e din se sa problem ka qenë në atë kohë që të realizohen projektet. Gjithashtu, e din ti mirë edhe që ka pas edhe kufizime buxhetore nga ana e qendrës. Do të filloj pak nga bujqësia, të të t'ri rikujtoj ty edhe qytetarëve se ndoshta i kanë harrue, se tash mund edhe të shantazhohen qytetarët, se ato ka vite që janë përfunduar. E din që për herë të parë është bërë subvencionimi i fermerëve, lopëve, deleve, shpezëve, bletëve, e kështu me radhë. Shpërndarjen e s'di sa mështjerrave që është bërë në kohën e atij ekzekutivi, që në krye ta saj ka qenë Shaban Shabani. Furnizimin me fidane, mbi 65 fermerë, në atë kohë, në këtë kohë as që është marrë parasysh. Shpërndarjen e 470 deleve, në bashkëpunim me TIKA-n dhe Shoqatën e Deleve të Kosovës, në këtë mandat as që është diskutuar. Organizimi i panairëve për promovimin e produkteve në Dragash dhe në pesë qendra të Kosovës, për herë të parë ne e kemi filluar e ju e keni vazhduar. Furnizimi me malina, dredhëza, aronia, boronicë, për fermerë të Komunës së Dragashit, përmes bashkëfinancimit me CARITAS-in zviceran dhe fermerë. E kemi bo ne, juve nuk ju ka shkue ndërmend ta bëni. Subvencionimin e qumështoreve, në atë kohë e kemi bërë ne, në këto katër vite nuk është bërë asgjë. Vazhdojmë tek turizmi. I dish mo, nuk po e përmendi, dy projektet më të rëndësishme të Komunës sonë, asfaltimi i rrugës Zhur, e dish, dhe Tyrbe-Zaplluxhe. Pastaj e kemi pas zgjerimin e rrugës Dragash-Brod. Kanë qenë të kryera po nga ai ekzekutiv. Asfaltimi i rrugës Zaplluxhe-qendra turistike, ka qenë po nga ai ekzekutiv. Asfaltimi i rrugës Trokan-Liqeni i Breznes; asfaltimi i rrugës Strazimir-Restelicë, e shumë e shumë, që s'po hyj tash të gjitha me i numëruë, se janë të shumta. Do të vazhdojmë edhe me disa ku ju nuk keni bërë asgjë, nuk po diskutoj tek infrastruktura se edhe ju keni punue, natyrisht. Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ti e dish, në atë kohë ke qenë edhe pjesë e këtij Kuvendi, kur

kemi bërë lirim nga taksa komunale të bizneseve për ushtrimin e veprimtarisë afariste për bizneset e reja dhe ekzistuese. E din mirë ti këtë. Gjithashtu, do të vazhdojë pak tek lirimi që ka ndodhë edhe nga qiraja për një vit e gjysmë për shfrytëzuesit e pronave komunale gjatë pandemisë, e shumë e shumë tjera, që besoj që nuk kam edhe kohë t'i numëroj tash, sepse është tepër. Të nderuar kolegë, asambleistë, ti e din që edhe në arsim jemi të parët që kemi filluar ndarjen e bursave për studentët, dhe bursa kena dhënë me çmime të mira, me çmime të cilat studentët kanë mund të kryejnë shpenzimet e tyre. Gjithashtu, edhe shkollat të shumta kemi ndërtu, amfiteatre, renovime, e kështu me radhë. Ma shumë s'po due me vazhdue për të arriturat e atij ekzekutivi, edhe pse të thashë se e ka pas shumë të limituar mundësinë që ta shfrytëzoj në tërësi buxhetin. Do të dal pak të diskutoj për problemet, më shumë të them premtimet që ka dhënë kryetari për fshatin tim, të cilat, jemi në përfundim të mandatit dhe nuk i ka realizue. Projekte shumë të rëndësishme për fshatin tim, njëri prej tyre është asfaltimi i rrugës së bjeshkës. Unë këtë projekt e kam lënë të gatshëm, ka qenë projekt trevjeçar, është bërë vetëm asfaltimi i shtresës së parë, ndërsa shtresa e dytë nuk është bërë, sot e asaj dite nuk është bërë asgjë dhe ka mbet ashtu, ndërsa premtimi ka qenë i këtij ekzekutivi se do të shtrohet edhe shtresa e dytë. I nderuar kryetar, çka ndodhi, pse nuk e përfundove edhe shtresën e dytë të asfaltimit të kësaj rruge. Gjithashtu, një pyetje ta kam parashtruar shumë herë, e din ti, problematikën e shtratit të lumit. Edhe këtë vit ta kam parashtruar po nuk e mbaj në mend në cilën seancë. Më premtove, thaje që këtë vit do ta bëjmë pastrimin e shtratit të lumit. Deri në këtë moment nuk ka asgjë. Më 12 i kena zgjedhjet, kështu që, çka u bo, kryetar? Pse nuk e përfundove edhe këtë projekt të cilin e premtove? Gjithashtu, unë besoj që është mo seanca e fundit dhe nuk do të kemi më mundësi tjetër të paraqitemi para jush, të nderuar të pranishëm, por edhe para të gjithë qytetarëve, e shfrytëzoj këtë mundësi të falënderoj Zotin që, përmes votës suaj – të nderuar qytetarë të Dragashit, e në veçanti ju bashkëfshatarë të mi dhe bashkatdhetarë, ma mundësuar që në këto dy mandate të shërbej për ju dhe në të mirën e juaj. Për mua ka qenë nder i madh, që të jam përfaqësues i juaj në këto dy mandate, por natyrisht edhe përgjegjësi. Jam munduar, ndoshta kam dhënë maksimumin tim, sidomos në katër vitet e para, që këtë mundësi që ma dhatë, unë t'ua kthej në një formë, besoj në formën më të mirë të mundshme, duke i zgjidhur shumë probleme të cilat unë i kam gjetur në fillim të mandatit tim. Gjithashtu, ju falënderoj edhe juve ekzekutiv, kolegë të nderuar, të cilët keni qenë shumë korrektë ndaj meje. Dhe, një falënderim i veçantë shkon edhe për mediat të cilat ua kanë mundësuar të gjithë qytetarëve të Dragashit të na ndjekin live dhe të shohim se kush ka kontribuar, çka ka dhënë, në këto ulëse,

për ta, edhe kush ka marrë rrogën vetëm si rrogë dhe nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. Të mos harroj, edhe juve që jeni kandidatë për zgjedhjet e 12 Tetorit, të ju uroj suksese. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje, deegatë! Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Nuk kam ndërmend të ju jap përgjigje gjithë asaj retorikës të cilën ju e bëni për fushatë elektorale. Ju uroj sukses që të fitoni, mirëpo natën e Bajramit nuk trashet kurhani. Disa u munduat ta trashni. Unë do të mundohem vetë të ju jap përgjigje në aspektin profesional dhe në aspektin financiar. E para, shpeshherë u ngrit çështja nga delegatët për mosndarje të buxhetit fair play. Rezultati dhe përgjigja më e mirë është mirënjohja nga DEMOS-i e cila iu dha sektorit të Financave në Komunën e Dragashit, e cila arriti që për katër vite, me në krye Bexhet Xheladinin, ta plotësojë komplet kontratën kolektive dhe të mos ketë huazime buxhetore, dhe të mos e shti në obligime kontraktuale Komunën. Dhe hyri në mesin e katër komunave më të mira. Gjithashtu, 62.5% kryetari Bexhet Xheladini u shpall kryetari më i mirë në Kosovë i realizimit të premtimeve konkrete në Komunën tonë, për investime kapitale. Jemi në mesin e katër komunave më të mira, të shpallura nga DEMOS-i dhe organizatat ndërkombëtare si komunë, për katër vjet, investime konkrete, që i kemi ekzekutue në terren. Të gjitha këto rezultate për të cilat na vlerësojnë ata të cilët janë të thirrur për me na vlerësue, neve nuk kemi bo shumë publicitet, sepse është natyra jonë që të punojmë dhe më pak të folim. Mirëpo, kur po e shoh që dikush po mundohet edhe humbjet e veta, edhe papunën e vet ta shpalla si fitore, atëherë po na detyron që t'u japim edhe përgjigje. Janë disa gjëra që realisht duam t'i themi. Kur kemi thënë se 96 arsimtarë i kemi gjet me norma të paplotësuara, nuk e fajësoj qeverinë e kaluar. Ka qenë aftësi e tyre, është aftësi e jona që gradualisht ata profesorë t'i mbajmë dhe vazhdojmë t'i riciklojmë sot e kësaj dite. Na shkaktojnë vështirësi, por problemi është mungesa e orëve, mungesa e nxënësve, mungesa e fëmijëve, nuk është mungesa e aftësisë qeverisëse. Përkundrazi, vullneti i kryetarit dhe qeverisë lokale, të gjitha këta arsimtarë riciklohen dhe sot e kësaj dite e kemi këtë gjendje. Në aspektin profesional, sa po punohet ose jo, janë arsimtarët dhe drejtoritë tjera të cilat flasin. Këtu u tha nga një parafolës se, përpos për kokë banori, ndahet edhe për territor. Është mirë ta thuash këtë, por është mirë edhe ta kuptosh. Për mirëmbajtje paguhen paret nga mallra dhe shërbime. Në qoftë se një shërbim edhe një mall kushton ma shtrenjtë për në territorin e Gorës, hyjnë në komplet të njëjtin kod, dhe ai nuk ndahet i Gorës dhe i Opojës. Ai është shpenzim, një kod është. Tash, a harxhon traktori 10 litër naftë më tepër që shkon prej Dragashit deri në Restelicë, ne e paguajmë prej të njëjtit kod. Balancimin në buxhet e

bën vetë natyra. Edhe të dalish këti të diskutosh me pompozitet se po bëhet diskriminim në buxhet, kjo nuk është reale. Monitoruesit të cilët neve na monitorojnë, Auditori Kombëtar neve na ka vlerësue me raport ekselent. Pikërisht këto shpenzime kontrollohen se a janë në rregull dhe a s'janë në rregull. Metoda e vlerësimit është metoda krahasimore. Dhe, në raport me të gjitha qeverisjet deri më tash, Qeverisja Bexhet Xheladini, e them pa modesti, është më e mira në këtë drejtim. Prandaj, unë ju uroj sukses juve, edhe disa jeni mësue edhe me folë për katër vite. Po mu po më vjen keq që disa jeni mësue me shit me skija, ndoshta ju ka mbet prej Banjskës. Dhe, kjo mu po më vjen keq, ma mirë është sot që shoqërisht edhe kolegialisht për 12 Tetorin t'iu uroni sukses njëri-tjetrit, cili të jeni më i mirë, urdhëroni hajdni, edhe ju themi mirë se vini këtu.

Arijeta Skeraj: Unë ndihem shumë e privilegjuar që e kam pas mandatin si kryesuese dhe jam shumë krenare që asnjë pikë nuk më ka mbet pa votue gjatë seancave të mia, dy vite radhazi që e mbaj këtë post. Është folë e është përfolë shumë këtu debat, secili në mënyrën e vet edhe në mënyrën e duhur. Por, unë jam falënderuese për votën, për të gjithë kritikën dhe për çdo gjë. Dua ta falënderoj edhe kryetarin, bashkë me qeverisjen e vet, që gjithmonë ka qenë në bashkëpunim me Kuvendin. Do të jam falënderuese për të gjithë, edhe për mediat që kanë qenë gjatë kohës këtu. Pak më herët, nga një asambleist u tha që ti ke me u mbajt në mend që ia kam ndalë të drejtën e fjalës. Shumica e dinë këtu që unë nuk ua kam ndalë të drejtën e fjalës. Zotëri Sejdlar më ka thënë që ti ma ke marrë të drejtën. Ti, zotëri Sejdlar, që je komuniteti goran, nuk e ke votue nënkryetarin goran. Ti ke me u mbajt në mend si personi më përçarës i Komunës së Dragashit. Ti nuk e ke votue buxhetin e Komunës së Dragashit. Si mund të lypish projekte, kur nuk e votojsh një buxhet? Unë që 18 vjet jam në Asamble, mundesh lirisht me pyet, kam qenë edhe opozitë, gjithmonë është votue buxheti. Buxheti është për njerëz që jetojnë në Komunë të Dragashit, jo për fontanë dëshirash. Ti e dish që shumë herë e ke marrë fjalën vend e pa vend. Ti shumë herë më ke lëndue, më ke thënë mbaje Rregulloren, a vetë nuk ke qenë i rregulluar. Në qoftë se ti nuk ke punuar Gorë, qysh mundesh me thënë kur buxheti i Komunës së Dragashit është 41% për Gorën. A je në dijeni ti si asambleist ndarja e buxhetit që është 59% për Opojën dhe 41% për Gorë? Në qoftë se nuk po i shohish këto gjëra të mira që po ndodhin në Gorë, atëherë unë nuk po e di a je në Asamble a ku je. Mu më vjen keq që për herë të parë një zv/drejtoreshë u bë nga komuniteti goran, e ti në këtë foltore e ke kritikue. Ti nuk je me Gorën, e jo unë. Të Munir, te Edini, te Miralemi, po të m'i kishin thënë këto fjalë, atëherë isha ndër keq. Për Sejdlarin që m'i thotë këto fjalë, aspak nuk ndihem keq. I vetmi që e ka përdorë këtë foltore për përçarje, për shtirje, edhe nuk ka qenë asnjëherë një

asambleist që ka dalë pa u çue 20 herë edhe pa bo skena të ndryshme. Të gjitha aktivitetet që janë mbajtur në Gorë, unë si kryesuese, bashkë me kryetarin, në të gjitha aktivitetet e Gorës kemi qenë. Edhe në iftar kemi qenë. Pse si asambleist nuk ka ardhë edhe nuk i ka përkrah goranët? E mos të më thotë mu që ti ke me u mbajtur në mend. Ti ke me u mbajtur në mend, z.Sedjilar, që ti kurrë nuk ke qenë për goranët. Ti ke me u mbajtur në mend që edhe kërkesën, para tri ditëve, nuk ia ke votuar Feimit. Këto janë shumë fakte. Atëherë, më lejoni të gjithë asambleistëve që janë në garë, t'u uroj sukses. Kryetarit të Komunës i dëshiroj shëndet, i dëshiroj edhe një mandat. Kush të fiton më 12 tetor, ishalla ka shëndet dhe vazhdojmë tutje!

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit shumë, znj. Kryesuese, për mua do të ishte shumë keq që ju të më lavdëronit. Derisa ju më kritikoni, lavdia ime është e madhe. Nuk ka lavdi më të madhe për mua sesa ju të më kritikoni. Është mirë që i keni lavdëruar mediokritetët dhe satelitët tuaj që ju kanë mbështetur gjatë gjithë këtyre viteve, por meqë kam vetëm dy minuta, do të filloj me radhë që t'ju përgjigjem. Dora ime kurrë nuk do të ngrihet për të votuar një buxhet të shëmtuar e diskriminues. Sot disa herë kam kërkuar që të më llogarisin përqindjet, zotërinjtë që kanë propozuar buxhetin nuk kanë arritur t'i llogarisin, por nuk ka problem – këtë do ta llogarisë populli. Populli im e di shumë mirë kush jam unë, kush jeni ju dhe si qëndroj unë me popullin, e si qëndroni ju – nuk dua të futem më thellë në këtë. Është e vërtetë, znj. Kryesuese, që unë këtu e kam kritikuar hapur emërimin e vajzës së znj. Ventaze Esati për zëvendësdrojtoreshë të Qendrës së Mjekësisë Familjare. Dhe me këtë krenohem hapur sepse e kam dëshmuar nepotizmin tuaj, e kam dëshmuar shikimin tuaj partiak ndaj gjërave. Prej gjithë atyre grave, prej gjithë atyre njerëzve në Gora, si e gjetët pikërisht vajzën e znj. Ventaze Esati, e cila atëherë kishte vetëm 32 ditë përvojë pune? Në spital kemi mjekë që kanë lënë jetën e tyre, kemi njerëz që janë të punësuar 38 vjet aty – si duket që t'u vijë një vajzë e re t'u bëhet shefe? Ju falënderoj që e hapët këtë çështje sepse për mua është shumë e rëndësishme. Sa i përket infrastrukturës, znj. Kryesuese, sërish ju falënderoj që e keni hapur dhe që keni filluar të mburreni me të. Populli e sheh shumë mirë si zhvillohen punimet, cilat janë cilësitë e punimeve në Gora dhe sa vonohen ato. Infrastruktura është “fenomenale”. Merrni makinën tuaj, shkoni në Kukuljane dhe kthehuni prapë e do të shihni çfarë ka bërë pushteti juaj. Të mos flas më shumë për këtë. Dhe gjëja e tretë, znj. Kryesuese – ju më keni akuzuar për 10 minuta, mund të më dëgjoni për 15 sekonda. Të nderuar qytetarë, në fund ju keni për të vendosur mes meje dhe tyre. Faleminderit.

Uran Halimi: E mora fjalën, se u përmenda, u akuzova për mosvotim të buxhetit. Ju e dini që vitin e parë të qeverisjes ne e kemi votuar buxhetin, LVV e ka votue buxhetin. Përpara vitit të parë të qeverisjes, LVV ia ka dhënë besimin kryetarit, ish-kryetarit të LDK-së, edhe kryetarit i tanishëm në ikje, z.Xheladini, duke bërë koalicion me ta. Edhe, e dini shumë mirë që pasi i besuam, e prurim në pushtet, ia votuam buxhetin, këta i ndotën duart me atë buxhetin, duke vjedhur kaptazhat e ujësjellësit të fshatit Blaç. Prej atëherë, s'kam resht asnjëherë, e s'kam me resht prapë se prapë, edhe nuk e miratoj e as votoj, e as përkrahi një buxhet ku ju i përlyeni duart aty. Ke qenë, i nderum z.drejtor, kryetar i partisë atëherë kur unë ju kam besuar, ju kam përkrahur, ju kam prurim këtu ku jeni. Edhe ju çka bëtë?! E tradhtuat Uranin, LVV-në, Afroren, Jetmirin edhe krejt përkrahësit edhe votuesit e LDK-së. Edhe tash, vijsh këtu edhe më kallxojsh për qeverisje. Ne jemi këtu, e dimë çfarë qeverisje është bo. Folni për arsim, për orë të plotësime, e nuk folni për ato orët e munguara që kemi diskutuar këtu. Unë nuk ju kuptoj, ju edhe tradhtarë, edhe krenarë, veç te ju e kam pa këtë. Faleminderit shumë!

Bexhet Xheladini: Unë do t'ua përmendi emrat të gjithë atyre të cilët më kanë parashtrur pyetje, nuk do të thotë që ata kanë të drejtë të replikojnë. Uran Halimi më ka bërë pyetje, unë duhet t'i përgjigjem atij. Unë muj edhe mos me ta përmend emrin fare. Atëherë, nuk po ta përmendi emrin. Shikoje veç këtë fotografi! Kush është qeky, edhe kush është qeky? Është Adem Hoxha, edhe është kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tash ish-kryeministri edhe kryetari i partisë tënde. Unë po ua kthej le ta shohin. Kur ju duhet juve, është jashtëzakonisht i mirë. Kur ua kthen shpinën ky, është tradhtar. Ta tregoj edhe një fotografi tjetër. Këtu e ke kryeministrin tënd edhe tonin, tash kryetar i partisë tënde. Këtu e ke Adem Hoxhën, këtu e ke presidenten edhe ky tjetri nuk po e di kush është. Adem Hoxha është deputet i Parlamentit të Kosovës, i cili është zgjedhur deputet me ligjet e Republikës së Kosovës. Është qytetar i Komunës së Dragashit edhe qytetar i Republikës së Kosovës. Ti vetë thaje 14 mijë euro unë të tregoj ku me i marrë, edhe më pyete ku kanë shkue. Edhe vetë thaje vitin e kaluar. Një njeri, një asambleist, me e përmend, merri paret e vitit të kaluar edhe shfrytëzoi këtë vit. Shko pyete kryeministrin ose qeverinë ku i ka çue, se na i ka marrë. Ujësjellësin e Shajnes e ke përmend, ne këtë e kemi në projekt, por është në kuadër të infrastrukturës. Mos u mërzit, se për ujësjellësin në Shajne dhe shumë projekte ka qenë asambleistja e nderuar në zyrën time, nga fshati Shajne, edhe kryetari i fshatit Shajne, edhe i kanë prurim kërkesat për fshatin Shajne. Të gjitha kërkesat ata që i kanë prurim, ne i kemi qit në buxhet edhe ata janë të kënaqur. Nuk e di ty ku po të dhemb, e pse po e bën një gjë të tillë, edhe kush të ka

thënë. Sa i përket që është lidhë ndriçimi publik i stadionit të vogël tek ju, edhe i këndit të lojërave të fëmijëve, ilegalisht, ata nuk e di. Por, nëse është lidhë, nuk është mirë. Por, nuk është mirë që edhe ti për çdo ditë po shëtit me kerr pa tabela dhe pa regjistruar. Sa i përket deputetit më të zëshëm, më përçarës në Asamblenë Komunale, unë do t'i përgjigjem pa ia përmend emrin. E përmendi ndarjen e subvencioneve, për Miralem Rahten. Unë me qenë si Miralemi, menjëherë ty të paditi, për arsye se nga Agjencioni Antikorrupsion e kemi marrë përgjigjen që këtu nuk ka konflikt interesi, edhe z.Miralem Rahte nuk është pronar i asaj OJQ-je. Ekziston dokumentacioni për të, ti ke ngrit zhurmë edhe më herët, edhe kjo nuk është e vërtetë. Për sa i përket asaj në Komitet për Komunitete, kur të marrë pjesë nënkryetari është një lloj sikurse me marrë pjesë kryetari. Edhe në Komitetin për Komunitete asnjëherë nuk kemi pas probleme. Kështu që, me pas pas ndonjë problem, unë kisha ardhë me ndihmë. Për kërkesën e fshatit Mlik u bo zhurmë, nuk e di për çka është fjala. Është mirë, në një bisedë në zyrën time private me ardhë me ma shpjegue, se vërtet nuk e di çka është fjala. Sa i përket asaj që t'u ka mohue e drejta për të diskutue, kjo nuk është e vërtetë. Je asambleisti më i zhurmshëm, më i pakëndshëm, një asambleisti që 99% e teleshikuesve kur të dalish ti e shymin televizorin. Sa i përket kërkesave në fushën e arsimit, shkarkimin e dy drejtorëve, nuk është e vërtetë. Ne, asnjë drejtor nuk e kemi shkarkue, përveç drejtorit të Gjinnazit. Të gjithë drejtorët tjerë a kanë kryer mandatin dhe pastaj, me procedura, dikush me performancë, e dikush me dorëheqje vullnetare, janë ndërrue ata, janë emëruar njëherë ushtrues detyre, pastaj me konkurs janë zgjedhë edhe drejtorë në bazë të ligjit. Sa i përket asaj se 62 mësimdhënës pa normë e 96 me normë, nuk e di këtë shifër. Unë nuk besoj që është e vërtetë, vetëm ka mundësi që të jenë me normë pak më të vogël këta arsimtarët dhe profesorët që mësojnë në mësimin në gjuhën boshnjake. Për transportin e nxënësve nuk kemi ndarë ka 120 mijë euro, por i kemi ndarë ka 250 mijë euro në vit. Për nxënësit me nevoja të veçanta, nuk e di që ka ndonjë kërkesë ka ardhë e unë e kam refuzue. Unë kam aprovue kërkesa, drejtorja ka aprovue kërkesa, por te unë nuk ka ardhë asnjë kërkesë. Nesër me ardhë, unë ia miratoj. Tek unë nuk ka ardhë asnjë kërkesë e personave me nevoja të veçanta, të cilët shkojnë në shkolla speciale në Prizren ose në Pejë, nuk ka ardhë tek unë që e kam refuzue. Kjo është e vërtetë. Ato kërkesa bjeri nesër, nesër unë i miratoj. Sa i përket regjistrimit, nuk është regjistruar asnjë nxënës - unë pyeta në telefon – 5 nxënës tanë qenkan regjistruar në mjekësi, 1 në mjekësi dhe 4 në stomatologji. Sivjet. Unë pyeta në telefon, e vërtetova. Kush nuk beson, le ta vërtetojë. Për kuizet e diturisë që thatë se nuk janë mbajtur. Unë kam marrë pjesë në një garë të kuizit të diturisë në Bellobrad – vetë kam qenë prezent në finale. Kështu që,

janë mbajt, shkollat kanë mbajt, edhe kuize të diturisë thuajse mban çdo shkollë. Për punë jashtë orarit, kujdestari natën, është kodi i pagesës, nuk do të thotë që janë pagine kujdestaritë e natës, por kodi i pagesës është i tillë edhe janë pagine mëditjet. Është kodi i pagesës, paguhen mëditjet me atë kod. Nxemja qendrore në Bresanë, nuk është e vërtetë që nuk punon. Nuk është e vërtetë as që frigoriferi nuk punon. Frigoriferi ka inverter në Bresanë edhe punon non-stop, kurrë nuk është ndalë, se aty ruhen vaksinat. Për ato reshetkat, nuk e di ku ke lyp, po ajo nuk është problem. Këndin e lojërave për fëmijë, thashë, mjetet i ka marrë përmbartuesi dhe ajo do të bëhet vitin e ardhshëm. Salla nuk është përfunduar, unë e di që salla është përfunduar, janë golat, janë koshat, janë të gjitha gjërat që është dashtë me qenë në tender. Shkollat nuk kanë kamera: kamera kanë, po ndoshta diku nuk funksionojnë. Siguria në trafik, ju e dini që disa fshatra në mënyrë vullnetare kanë vendosur policë të shtrirë, por Ministria e Transportit ka ardhë i ka hek edhe i ka marrë me vete, kështu që ato nuk po lejohen me i vendos në rrugët magjistrale, kjo nuk është kompetencë e jona, kjo është kompetencë e Ministrisë. Duhet me marrë leje, ata me i vendos. Disa fshatra i kanë vu vetë, por Minsitria i ka hek. Sa i përket Miralem Rahtes, unë e dhashë përgjigjen, e kemi përgjigjen e Agjencionit Antikorrupsion. Këtu nuk ka konflikt interesi. Edhe, u përmend ndarja e drejtë, nga 18%, brenda ditës hypi në 24%, ma vonë erdh në 39%. Por, nëse i llogaritni mirë, sigurisht se ka me dalë 40%, ashtu qysh kam thënë. Nëse këtyre mjeteve ia shtojmë edhe 350 mijëshin e Ministrisë, del që 55% mjete më shumë kanë shkue në pjesën e Gorës sesa në pjesën e Opojës. Por, ato ne nuk i llogaritim. Kështu që, ne duhet me qenë pak më zemërgjerë, sepse jemi një brum. Ata të cilët dojnë me na nda, me na përça, atë më nuk do të kenë vend këtu. Edhe një herë, për këtë gabimin e kërkesës së fshatit Mlik kisha pas dëshirë, kush e din, me ardhë në zyrë me ma tregue. Një asambleist i PDK-së doli dhe bëri fushatë, e keqpërdori këtë foltore, e shkeli Ligjin mbi Zgjedhjet. Bëri promovim politik, edhe i keqpërdori edhe mjetet e informimit të cilat paguhen nga taksapaguesit e Komunës sonë. Këtu bëri fushatë çka kanë punue para këtij mandati edhe afër 95% tha gjëra të pavërteta. Foli për panairin, atë ne e kemi bërë qe katër vite. Ju nuk keni pas panair, ne i kemi paguar njerëzit të cilët marrin pjesë në panair. Lirimin nga tatimi e ka pru Asambleja, ne e kemi implementuar. Nuk po due me i përmend, por 95% të atyre që i tha nuk janë të vërteta. Nuk po due me e keqpërdor këtë foltore. Sot ne e kemi hapjen e fushatës, atje do të flas unë se çka kam me bërë e çka kam bërë edhe cilat janë planet e mia. Unë do t'i them atje, e jo këtu. U përmend shumë kjo puna e drejtoreshës. Unë jam shumë i lumtur që kam arrit që, në mandatin tim, në QKMF të Dragashit ta emëroj një grua në pozitën e zëvendës drejtoreshës. Kjo është një e arritur e

madhe e imja, që për herë të parë në historinë e ekzistimit të Komunës së Dragashit, QKMF-ja sot ka zëvendësudrejtor të komunitetit joshumicë. Edhe jam i lumtur, edhe më vjen shumë mirë që ajo doktoreshë është duke e krye punën shumë ekselent. Një përfaqësues i VV-së foli shumë për të kaluarën, për koalicionin, për shumë gjëra tjera, por nuk dua me u fut në këso debate, këto janë më debate të tejkaluara. U përmend edhe përqindja e punësimit në Komunën e Dragashit. Unë jam kryetari i cili e kam rrit numrin e të punësuarve në Komunën e Dragashit. Nuk e kam bërë më të mirën të mundshme, për shumë arsye. Arsyeja e parë është mungesa e kuadrove, ne çdo herë kemi hap konkurse, jemi detyruar dy, tri a katër herë me i përsërit konkuret dhe njerëzit nga komuniteti joshumicë nuk kanë konkurrue në konkurse. Kemi pas raste kur ne i kemi pranuar kuadrot nga komuniteti joshumicë, është fjala për një kuadër – e di gjuhën shqipe, gjuhën boshnjake, gjuhën serbe, gjuhën angleze, edhe ka pas shumë një përvojë të madhe me faktorin ndërkombëtar, ka pas përvojë pune më shumë se katër vjet. E kemi pranuar në punë - një deputet i Parlamentit të Kosovës nga radhët e komunitetit joshumicë që jeton në Prizren e ka bo ankesën në KPMSHC, ata e kanë gjet një parregullsi, nuk ia kanë pranue stazhin e punës që e ka pas në IOM, katër vite, i kanë thënë nuk e ke trustin. Edhe, e kanë largue atë person. Tash, kemi shkue e kemi lut atë me konkurrue prapë, ai më e ka gjet një punë tjetër, nuk po do me ardhë. Kështu që, shumë herë kemi edhe konkurse të hapura, mujn me konkurrue. Kemi konkurse. Kemi pranue punëtorë nga komuniteti joshumicë, sot e kemi pranue, nesër e ka lënë punën. Kështu që, atë përqindjen që s'po mujm me e arrit, është problemi te arsimit, ku aty kemi numër më të vogël të të punësuarve, edhe ka ma pak nxënës. Kështu që, unë do të përmendi përqindjen, në total është 28% numri i të punësuarve në Komunën e Dragashit, nga komuniteti joshumicë. 24% ka qenë unë kur e kam marrë detyrën, edhe atë në Drejtorinë e Administratës 24%, në Drejtorinë e Ekonomisë është 43%, në Drejtorinë e Bujqësisë është 20%, në Drejtorinë e Urbanizimit 33%, në Drejtorinë e Shëndetësisë është 50%, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është 50%, në DKA është 17%, në DKRS është 20%, në Zyrën e Komuniteteve është 67%, Zyra e Kryetarit 14%, edhe Zyra e Prokurimit 33%. Ne total është 28% numri i të punësuarve. Në të ardhmen është mirë që këtë numër me e përmirësue. Dhashtë Zoti që komuniteti joshumicë të ketë kuadra edhe të konkurrojnë më konkurse për t'i pranuar punëtorët, edhe me e rrit përqindjen e të punësuarve. Faleminderit për vëmendjen! Ju dëshiroj të gjithëve suksese, gjitha të mirat në jetë dhe shëndet!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Nuk do të diskutojmë më! Besoj se keni pas përgjigje prej kryetarit. E mbylli këtë seancë! Ju faleminderit!